



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Përputhshmërie)

MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

JANAR 2023

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....3
2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....4-7

II. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....7-9**III.HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)**

- a) Objektivat dhe qëllimi.10
b) Identifikimi i çështjes.....10
c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese10-11
d) Përgjegjësitë e audituesve.....11
e) Kriteret e vlerësimit.....11
f) Standardet e auditimit.....11
g) Metodatat e auditimit..... 11-12
h) Dokumentimi i auditimit.....12

IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.....12-13
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....13
2.1. Aktiviteti i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët13-19
2.2 Aktiviteti i Agjencisë Kombëtare të Rinisë19-42

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....42-46**VI. ANEKSE.....47**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.791/3 datë 15.09.2022, në Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë, nga data 14.09.2022 deri më 31.10.2022, për periudhën e auditimit 01.01.2021 deri më datë 31.08.2022, u krye auditim Përputhshmërie.

Grupi i auditimit, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit mbi aktivitetin e përputhshmërisë së veprimtarisë së MSHRF dhe AKR, auditoi drejtimit kryesore, në auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore, të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe fëmijët është përgjegjës për hartimin, zhvillimin dhe monitorimin e politikave rinore, dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirë edukimin e fëmijëve. Ministri i Shteti për Rininë dhe Fëmijët ka përgjegjësinë të fuqizojë përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse të politikë bërjes, duke mbrojtur të drejtat e të rinjve, duke krijuar kushte të nevojshme për aktivizim e pjesëmarrje.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) garanton dhe promovon të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Sa më sipër, MSHRF dhe AKR vepron mbi bazën ligjore të mëposhtme:

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

-Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;

-Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;

- Ligji nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”.

-Ligji nr.75, Datë 4.11.2019 “Për Rininë”;

-Vendimi nr.681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”;

-Vendimi nr.524, datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët”.

Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë MSHRF dhe AKR, në mënyrë për të bërë të mundur ndër marrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synimin e mirë përdorimit të fondeve publike.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk janë ndërmarrë hapa për zhvillimin e kompetencave të rëndësishme për hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit mbi situatën e të rinjve; zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore; nuk janë monitoruar standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë, të parashikuara në Ligjin nr.75/2019 “Për Rininë” neni 5. Gjithashtu nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk janë hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikat, për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, nuk ka hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikat, për marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës; sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit, në zbatimin të VKM-së nr. 524, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët” pikat 3 dhe 4.</p>	13-18	I MESËM	<p>Nga ana e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të merren masa të menjëhershme lidhur me hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit të situatës së të rinjve, monitorimi i politikave dhe veprimtarive rinore, monitorimi i standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore duke dhënë në këtë mënyrë një vlerësim aktual mbi situatën reale të të rinjve në Republikën e Shqipërisë.</p>
2	<p>Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e projekteve që janë në proces nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit, si dhe ato që kanë përfunduar nuk janë të numëruara dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit sipas rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidentimin, sistemimin dhe</p>	19-41	I MESËM	<p>Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, të merren masa për kryerjen e</p>

	shfrytëzimin e dokumenteve.			inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.
3	<p>Nga auditimi u konstatua se për të gjitha procedurat e projekteve për Rininë nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta, e cila ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve U konstatua se edhe ato subjekte që i janë nënshtruar monitorimit, në fakt nuk janë dokumentuar me shkresa zyrtare por sipas institucionit vetëm nëpërmjet emaileve gjë e cila është e pamjaftueshme për të parë performancën e subjekteve përfituese .</p> <p>Monitorimi i projekteve duhet parë si një funksion thelbësor i aktivitetit të AKR-së, për të cilin duhet të ngrihen dhe funksionojnë struktura të plota dhe aktive, të afta të mbulojnë me monitorim një pjesë përfaqësuese të projekteve në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme mbi përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.</p>	19-41	I MESËM	Nga ana e strukturës përgjegjëse për monitorim, në AKR, të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik, të kujdesshëm dhe përfaqësues, dhe me objektiva të qarta për projektet në fushën e Rinisë, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet.
4	<p>Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Rinisë ka mbështetur realizimin e 12 projekteve për organizatat, për të cilat u konstatuan disa problematika si: në tre organizata, nuk janë respektuar afatet të vendosura në kontratë për disbursimin e kësteve, në një organizatë konstatohet se dokumentacioni i dosjes së aplikimit është i fotokopjuar, në një organizatë konstatohet se nga përfituesi është kërkuar shtyrje e afatit të kontratës, e cila është kërkuar disa ditë para mbarimit të afatit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me nenin 13 të kontratës ku përcaktohet se zgjatja në kohë e projektit ndodh pas një kërkesë nga Përfituesi, e dërguar të paktën 1 (një) muaj përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga AKR; në një organizatë konstatohet se mungojnë raportet përfundimtare. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 5, nenin 7, dhe nenin 13 të Kontratës e lidhur ndërmjet AKR-së dhe organizatave.</p>	19-41	I MESËM	Nga ana e strukturës përgjegjëse në AKR, në vijimësi të merren masa për respektimin e afateve të pagesave të kësteve dhe të shtyrjes të afatit të përfundimit të projektit sipas kontratës së lidhur midis AKR-së dhe organizatave.
5	<p>Nga auditimi konstatohet se:</p> <p>5.1.AKR-ja nuk ka përgatitur dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe</p>	19-41	I MESËM	Titullari i institucionit të AKR-së të marrë masa për krijimin e

	<p>PBA 2022-2024, formatet e raporteve të PBA-së, si dhe nuk ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 1.5 dhe paragrafi 2.5 pika 1/a, paragrafi 2.5 pika 5.</p> <p>5.2.Për periudhën objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12-mujore të buxhetit. AKR-ja financohet nga buxheti i shtetit për programin Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit me financim të brendshëm konsistojnë në rakordimet që AKR-ja bën me Ministrinë e linjës për rininë për arritjen e objektivave për të cilat alokohen këto fonde. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12-mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.</p>			<p>Ekipit të Menaxhimit të Programit, hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm së bashku me formatet e raporteve të PBA-së, çdo vit, me qëllim për të mundësuar një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.</p> <p>2.AKR-ja të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 4-8-12-mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimit sa më efektiv të fondeve buxhetore.</p>
6	<p>Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse, duke ju referuar VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit, janë konstatuar mangësitë si më poshtë: Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit; dosjet e personelit shoqërohen nga fleta e inventarit; kontrata individuale e punës; vlerësimi periodik i performancës; dokumentacion të panoterizuar; librezat e punës e paplotësuar me datën e fillimit të punës; lista e notave; Dëshmi penaliteti., veprime në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.</p>	19-41	I MESEM	<p>Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.</p>
7	<p>Nga auditimi u konstatua se AKR-ja nuk ka lidhur një Kontratë Individuale të Punës me secilin nga punonjësit e institucionit, si dhe nuk ka një kontratë tip , ku të përcaktohen të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punë si: a. identitetin e palëve; b. vendin e punës; c. përshkrimin e përgjithshëm të punës; d. datën e fillimit të punës; e. kohëzgjatjen kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; f. kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; g. afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; h. elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; i. kohën normale javore të punës; j. kontrata</p>	19-41	I MESEM	<p>Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që të hartojë një format tip që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës dhe të lidhë Kontrata Individuale të Punës me secilin nga punonjësit e institucionit.</p>

	e punës duhet të përmbajë dhe kontratën kolektive. Ky veprim është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11 pika 1 dhe neni 21 pika 3.			
8	Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e Brendshme e institucionit është miratuar me Urdhër të Ministrit të MASR nr. 103, datë 06.03.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Kombëtar për Rininë”. Me VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, është krijuar institucioni i AKR-së, të cilës i ka kaluar numri i punonjësve, buxheti i planifikuar dhe të gjitha asetet e Shërbimit Kombëtar për Rininë. Dhe pse kanë ndodhur këto ndryshime, AKR vazhdon të funksionojë sipas kësaj rregullore, e cila nuk është përditësuar me bazën ligjore në fuqi. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 681, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” pika 5 dhe 6.	19-41	I MESËM	Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të marrin masa për përditësimin e rregullores sipas ndryshimeve të ndodhura në organikën dhe strukturën e AKR-së.
9	Nga auditimi u konstatua se nga 4 projektet e fituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, 3 prej tyre në përfundim të afatit të kontratave nuk e kanë filluar ende implementimin e projekteve në kundërshtim me kontratat e lidhura. Përkatësisht 1-Bashkia Tiranë me projektin: “Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për të Rinjtë, Petrelë” ka lidhur kontratën nr.363, datë 23.11.2021, me vlerë financimi nga AKR 3,186,489 lekë, me afat 12 mujor . Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 2,867,840 lekë sipas kontratës. 2-Bashkia Elbasan me projektin “Talent St-Art-Up Elbasan 2”, ka lidhur kontratën me nr.5374, datë 03.11.2021, vlerë financimi nga AKR 5,503,842 lekë, me afat 10 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 4,953,485 lekë sipas kontratës. 3-Bashkia Lezhë me projektin “Rikonstruksioni i Qendrës Rinore Lezhë” ka lidhur kontratën me nr. 19199, datë 05.11.2021 vlerë financimi nga AKR 8,541,077,6 lekë, me afat 12 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 7,686,970 lekë sipas kontratës. Në këto kushte vlera e financuar nga AKR prej 15,508,295 lekë nuk është përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet, pasi konstatuam se projektet ende nuk kishin nisur fazën e implementimit në kundërshtim me kontratën.	19-41	I MESËM	Nga MSHRF dhe AKR të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos fillimin e implementimit të projekteve të bashkive, referuar kontratave së lidhur midis AKR-së dhe Bashkive Tiranë, Elbasan, Lezhë duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 15,508,295 lekë.

II. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi në Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë u konstatua se:

- Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk janë ndërmarrë hapa për zhvillimin e kompetencave të rëndësishme për hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit mbi situatën e të rinjve; zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore; nuk janë monitoruar standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë, të parashikuara në Ligjin nr.75/2019 “Për Rininë” neni 5.

Gjithashtu nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk janë hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikat, për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, nuk ka hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikat, për marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës; sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit, në zbatimin të VKM-së nr. 524, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët” pikat 3 dhe 4.

-Nga auditimi u konstatua se nga 4 projektet e fituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, 3 prej tyre në përfundim të afatit të kontratave nuk e kanë filluar ende implementimin e projekteve në kundërshtim me kontratat e lidhura. Përkatësisht 1-Bashkia Tiranë me projektin: “Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për të Rinjtë, Petrelë” ka lidhur kontratën nr.363, datë 23.11.2021, me vlerë financimi nga AKR 3,186,489 lekë, me afat 12 muaj . Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 2,867,840 lekë sipas kontratës.

2-Bashkia Elbasan me projektin “Talent St-Art-Up Elbasan 2”, ka lidhur kontratën me nr.5374, datë 03.11.2021, vlerë financimi nga AKR 5,503,842 lekë, me afat 10 muaj. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 4,953,485 lekë sipas kontratës.

3-Bashkia Lezhë me projektin “Rikonstruksioni i Qendrës Rinore Lezhë” ka lidhur kontratën me nr. 19199, datë 05.11.2021 vlerë financimi nga AKR 8,541,077,6 lekë, me afat 12 muaj. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 7,686,970 lekë sipas kontratës.

Në këto kushte vlera e financuar nga AKR prej 15,508,295 lekë **nuk** është përdorur me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet, pasi konstatuam se projektet ende nuk kishin nisur fazën e implementimit në kundërshtim me kontratën.

-Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e projekteve dhe dosjet e burimeve njerëzore që janë në proces nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe ato që kanë përfunduar nuk janë të numëruara dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

-Nga auditimi u konstatua se për të gjitha procedurat e projekteve për Rininë **nuk** ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta, e cila ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve.

U konstatua se edhe ato subjekte që i janë nënshtruar monitorimit, në fakt nuk janë dokumentuar me shkresa zyrtare por sipas institucionit vetëm nëpërmjet emaileve gjë e cila është e pamjaftueshme për të parë performancën e subjekteve përfituese .

Monitorimi i projekteve duhet parë si një funksion thelbësor i aktivitetit të AKR-së, për të cilin duhet të ngrihen dhe funksionojnë struktura të plota dhe aktive, të afta të mbulojnë me monitorim një pjesë përfaqësuese të projekteve në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme mbi përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

- Nga auditimi u konstatua se AKR-ja **nuk** ka përgatitur dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe PBA 2023-2025, as formatet e raporteve të PBA-së si dhe nuk ka

ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit, si dhe mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të AKR-së, të cilat dërgohen në ministrinë e linjës.

- Nga auditimi u konstatua se AKR-ja **nuk** ka përditësuar Rregulloren e Brendshme sipas bazës ligjore në fuqi.

- Nga auditimi u konstatua se AKR-ja **nuk** ka lidhur Kontratë Individuale të Punës me secilin punonjës pjesë e organikës, si dhe nuk ka një format tip të kontratës së punës, ku të përcaktohen të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës. Gjithashtu, u konstatuan disa mangësi në mbajtjen e dosjeve të personelit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i Pamodifikuar/ Pakualifikuar)¹

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit MSHRF dhe AKR me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e institucionit të MSHRF dhe AKR, në të gjitha aspektet është kryer në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe justifikon dhënien e një “Opinionit të Pakualifikuar” të përputhshmërisë”.

Baza për kufizimin e sigurisë të opinionit të përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e projektraportit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë” si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2018. Dokumentacioni administrativ, projektet, janë për zgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të vendimmarrjes nga MSHRF dhe AKR, me kriteret e parashikuara.

Nga auditimi i përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i MSHRF dhe AKR, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Drejtimi i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe i Agjencisë Kombëtare të Rinisë janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MSHRF dhe AKR, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetore të AKR për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues.

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri

¹ Sipas Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, **Konkluzionet/ opinionet e pakualifikuara:** Kur audituesi nuk ka raste mospërputhshesh materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar: Në rastin e angazhimit me siguri të arsyeshme, që informacioni mbi çështjen dhe objektin e auditimit është përgatitur në çdo aspekt material në përputhje me kriteret e vlerësimit;

ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

I. Hyrja.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.791/3 datë 15.09.2022, në Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë, nga data 14.09.2022 deri më 31.10.2022, për periudhën e auditimit 01.01.2021 deri më datë 31.08.2022, u krye auditim Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. EM (përgjegjës grupi),
2. BB, anëtar
3. AGj, anëtar

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit janë dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi.

Qëllimi i auditimit është, vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet janë në çdo aspekt në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

4) Identifikimi i çështjes:

Misioni i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është mbrojtja e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e pjesëmarrjes së tyre në jetën sociale, nëpërmjet hartimit, zhvillimit dhe monitorimit të politikave rinore, dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirë edukimin e fëmijëve. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët synon të fuqizojë përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse të politikëbërjes, duke mbrojtur të drejtat e të rinjve, duke krijuar kushte të nevojshme për aktivizim e pjesëmarrje.

Si institucion përgjegjës me në fokus rininë dhe fëmijët, Ministri i Shtetit krijon ura bashkëpunimi mes fëmijëve dhe të rinjve të Shqipërisë e atyre të diasporës, me përfaqësuesit e institucioneve publike e private, si dhe me organizata të shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

Misioni i Agjencisë Kombëtare të Rinisë është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit të të drejtave të të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimi e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në zbatim të Programit të Auditimit nr.791/3 datë 15.09.2022

5) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Ministri i Shtetit për Rininë dhe fëmijët është përgjegjës për hartimin, zhvillimin dhe

monitorimin e politikave rinore, dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirë edukimin e fëmijëve. Ministri i Shteti për Rininë dhe Fëmijët ka përgjegjësinë të fuqizojë përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse të politike bërjes, duke mbrojtur të drejtat e të rinjve, duke krijuar kushte të nevojshme për aktivizim e pjesëmarrje.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) garanton dhe promovon të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Veprimtaria e AKR-së shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke organizuar përgjegjësitë funksionale me qëllim sigurimin e kushteve për mbështetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut të strukturuar për të realizuar fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, krijimin e mekanizmave për nxitjen e politikave rinore si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve që kanë në fokus rininë shqiptare dhe rëndësinë e kësaj të fundit në shoqëri.

6) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objekti ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MSHRF dhe AKR-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit, ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

7) Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”.
- Ligji nr.75, Datë 4.11.2019 “Për Rininë”;
- Vendimi nr.681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”;
- Vendimi nr.524, datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët”.

8)Standardet e Auditimit

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;
- ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë;
- Libri Jeshil i GAO-s;

9) Medodat e auditimit

Auditimi ynë përfshin përputhshmërinë e aktivitetit të MSHRF-së dhe AKR-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, hartimin, zhvillimin dhe monitorimin e politikave rinore, financimin e veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

10) Dokumentimi i auditimit

Auditimi i përputhshmërisë është realizuar, në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), mbështetur në ISSAI-n 10 “*Deklarata e Meksikës*”, mbi Pavarësinë e (SAI), si dhe ISSAI 30 Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së si dhe Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017, e ndryshuar me Vendimin nr.63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

Grupi i audituesve, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit të përputhshmërisë e veprimtarisë së Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë u fokusua mbi zbatimin në mbështetje të kuadri rregullator në fuqi, në lidhje mbi zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, hartimin, zhvillimin dhe monitorimin e politikave rinore, financimin e veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë në zbatim të Ligjit organik të KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Ligjit 10296, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, “*Për Ndërmarrjet Shtetërore*”, -Ligjit nr.75, Datë 4.11.2019 “*Për Rininë*”, Vendimit nr.681, datë 02.09.2020 “*Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë*”, Vendimit nr.524, datë 22.09.2021 “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët*”.

IV. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirë edukimin e fëmijëve.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton, zhvillon dhe monitoron politikën, për: a) mbrojtjen e të drejtave të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; b) krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve; c) përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor për çështjet e rinisë; ç) bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë; d) të rinjtë shqiptarë në diasporë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për diasporën; dh) programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, zhvillon dhe monitoron politikën, për: a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi; b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikën kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikase, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës; c) sigurimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën; ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetit, bazuar në interesin më të lartë të tij; d) marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës; dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Agjencisë Kombëtare të Rinisë është institucion buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rininë. Misioni i AKR-së është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit të të drejtave të të rinjve, nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimin e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

AKR-ja ka përgjegjësi të organizojë veprimtarinë për: a) realizimin e funksioneve që lidhen me mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve; b) sigurimin e kushteve për rritjen e ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e të rinjve nga subjekte vendase ose të huaja; c) nxitjen dhe zhvillimin e dialogut të strukturuar, për përfshirjen e sa më shumë palëve, me synim fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri; ç) krijimin e mekanizmave për zhvillimin dhe nxitjen e politikave rinore, si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve të financuara nga buxheti i shtetit.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 AKTIVITETI I MINISTRIT TË SHTESTIT PËR RININË DHE FËMIJËT

-Nga auditimi u konstatua se Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, është krijuar sipas VKM nr. 524 datë 22.09.2021 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët".

Lidhur me fushën e përgjegjësisë së rinisë, Ligji për Rininë Nr. 75/2019 përbën bazën mbi të cilën janë hartuar dhe po hartohen programe të ndryshëm në lidhje me rininë.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029. Bazuar në germën a, të nenit 5, të ligjit nr. 75/2019 "Për rininë", Ministria përgjegjëse për rininë harton dhe propozon bazën ligjore, politikën, programet, strategjitë dhe veprimtaritë për rininë;

-Nisur nga mungesa e një dokumenti strategjik të mirëfilltë që përcakton prioritetet dhe orienton politikën publike në mbështetje dhe zhvillimin e rinisë shqiptare, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka ndërmarr nismën për përgatitjen e të parës strategji kombëtare për rininë në vend, me shtrirje shtatëvjeçare. Me urdhër të Kryeministrit, u ngrit Grupi Ndërinstitucional i

Punës i kryesuar nga MSHRF dhe me përbërje nga institucionet shtetërore kyçe dhe partnerët e huaj për zhvillim që vepron në fushën e rinisë, me përgjegjësi për:
Hartimin e draft-Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022 – 2029, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri dhe legjislacioni në fuqi.

Sigurimin e përfshirjes në draft-Strategji të:

Prioriteteve dhe objektivave të programit qeverisës në lidhje me rininë shqiptare;

Rekomandimeve të paraqitura në dokumentin e vlerësimit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015 – 2020.

Organizimin e takimeve konsultuese për hartimin e draft-Strategjisë, të përmirësojë cilësinë e tij bazuar në komentet, sugjerimet dhe rekomandimet që do të dalin nga këto takime konsultative, si dhe nga procesi i konsultimit publik në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Lidhur me statusin aktual: Dokumenti Strategjik se bashku me planin e veprimit është draftuar sipas metodologjisë IPSIS dhe u hodh për konsultim publik në Regjistrin e Konsultimeve publike dhe qëndroi i hapur deri në datë 8 shtator. Pas kësaj, dokumenti është hedhur në sistemin e-akte në pritje të mendimeve nga ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera të lidhura, për mendim.

Programi jashtë orarit mësimor i Arteve dhe zejeve. Në përputhje me parashikimet e Urdhrit nr. 150, datë 30.12.2021 të Kryeministrit për “Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e programit kombëtar dhe të planit të veprimit “Art, Zeje, Sport”, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës dhe plotësuar përbërja e tij me përfaqësuesit e caktuar nga institucionet shtetërore, sipas anëtarësisë së parashikuar në Urdhër .

Me shkresën nr.4829, datë 25.08.2022, janë përcjellë për dijeni dhe vendimmarrje rezultatet paraprake të Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e programit kombëtar dhe të planit të veprimit “Art, zeje dhe sport ” *Sipas këtij urdhri grupi institucional i punës kryesohet nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.*

Grupi ndërinstitucional i punës të thirret nga kryetari dhe të mbledhet çdo muaj ose sa herë që të vlerësohet e nevojshme, në varësi të problematikave të lindura në kuadër të procesit të punës, sipas këtij urdhri.

Nuk ka asnjë dokumentacion për mbledhjet e grupit për periudhën Janar - Gusht 2022.

Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të informojë Kryeministrin pas çdo takimi rreth mbarëvajtjes së hapave të projektit të kodimit.

Grupi ndërinstitucional i punës ka këto përgjegjësi:

- a) Të hartojë e të organizojë Program Kombëtar dhe planin e veprimit “Art, zeje e sport”;
- b) Të përcaktojë kriteret për përzgjedhjen e shkollave, ku do të fillojë implementimi I programit (brenda semestrit të dytë të këtij viti shkollor) nga hyrja në fuqi e këtij urdhri; (Mungojnë kriteret)
- c) Të hartojë udhëzuesin për Programin Kombëtar “Art, zeje e sport”;
- d) Të koordinojë takime dhe diskutime me grupe të ndryshme interesi sipas fushës në kuadër të hartimit të udhëzuesit;
- e) Të depozitojë, brenda një periudhe 3-mujore, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, udhëzuesin për implementimin e projektit fillestar në një zonë të caktuar, i cili do të shërbejë si model për detajet e implementimit të programit kryesor;
- f) Të përzgjedhë koordinatoren e përgjithshëm të programit nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, i cili do të koordinojë punën për zbatimin dhe raportimin e Programit Kombëtar "Art, zeje e sport", para grupit të punës;
- g) Të përzgjedhë koordinatoren e programit në çdo drejtori rajonale të arsimit parauniversitar, të cilët do të koordinojnë dhe do të raportojnë periodikisht te koordinatori i përgjithshëm dhe para ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;

- h) Të përzgjedhë koordinatorët e programit në çdo zyrë vendore të arsimit parauniversitar, të cilët do të raportojnë periodikisht para grupit të punës; (mungojnë raportimet)
- i) Të koordinojë dhe të monitorojë programin në institucionet arsimore gjatë gjithë viti shkollor;
- j) Te koordinojë dhe të monitorojë zbatimin e Programit Kombëtar "Art, zeje e sport".

Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të informojë Kryeministrin pas çdo takimi rreth mbarëvajtjes së hapave të projektit të kodimit.

Nga auditimi u konstatua se mungojnë raportimet.

Programet Jashtë Orarit Mësimor (JOM) njihen gjerësisht si ndërhyrje që iu ofrojnë fëmijëve dhe të rinjve kohë mësimore shtesë, mundësi për zgjerim horizontesh, si dhe përvoja të shumëllojshme të të nxënësve. Programi JOM është komponent integral i kuadrit të Shkollës si Qendër Komunitare, i cili është përshtatur dhe zbatohet në Shqipëri që prej vitit 2014. Ky Program ndërmerr hapa për të forcuar nismën "Shkolla si Qendër Komunitare", përmes realizimit mbarëkombëtar dhe gjithëpërfshirës së nismave JOM.

Struktura e organizimit të Programit JOM

Kurset janë të veçanta për çdo cikël: nxënësit e ciklit fillor do të përbëjnë një grup, logjikë e cila do të zbatohet edhe për ciklin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë, duke krijuar në këtë mënyrë, tre cikle, specifikisht: Klasa 1-5, Klasa 6-9, Klasa 10-12. Krahas kësaj, kurset do të ofrohen edhe sipas nivelit të aftësive: kurset e nivelit të parë do të jenë të disponueshme për të gjithë nxënësit e interesuar nga të gjitha ciklet, ndërsa kurset e nivelit të dytë do t'iu mundësohen nxënësve nga cikli i mesëm i ulët dhe ai i mesëm të lartë, që arrijnë rezultate të shkëlqyera. Kurset JOM të nivelit të parë do të zhvillohen në mjediset e shkollës dhe do të ndiqen nga nxënësit e shkollës përkatëse, si dhe do të realizohen nga mësuesit e po asaj shkolle. Kurset e nivelit të parë do të ofrohen rregullisht (dy herë në javë) gjatë gjithë vitit shkollor.

Kurrikula dhe dokumentacioni kurrikular i lidhur me secilën janë zhvilluar si më poshtë:

Artet dhe Zejet

Prodhimi kulturor përfshin artet e bukura, dekorative dhe të aplikuara, muzikën, teatrin, kinematografinë, folklorin dhe zejet tradicionale. Në vitin pilot, Programi do të përqendrohet përkatësisht tek muzika, kori, teatri, instrumente, arti pamor dhe zejet sipas zonave. Në bashkëpunim me UNICEF janë hartuar kurrikulat respektive për fushat e përzgjedhura. Gjithashtu në bashkëpunim me ekspertët e fushës, është hartuar edhe një listë e bazës materiale të nevojshme për realizimin e programit.

Teknologjia

Fusha tematike e Teknologjisë përqendrohet te programimi i softuerëve, kryesisht duke përdorur mikro kompjuterë të programueshëm. Kurrikula për teknologjinë është hartuar nga MSHRF, ASCAP në bashkërendim me AKSHI. Gjithashtu në bashkëpunim me ekspertët e fushës, është hartuar edhe një listë e bazës materiale të nevojshme .

Mjedisi dhe agrikultura

Fusha tematike e Mjedisit dhe Agrikulturës përfshin edukimin dhe sensibilizimin mjedisor dhe për qëndrueshmërinë, si dhe edukimin për agrikulturën, sistemet ushqimore, agronominë dhe agroekologjinë. Kurrikula për agrikulturën (kopshtet e gjelbra) është hartuar nga MBZHR në bashkëpunim me ekspertët e Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe ekspertëve të GIZ. Gjithashtu në bashkëpunim me ekspertët e fushës, është hartuar edhe një listë e bazës materiale të nevojshme për realizimin e programit, mbi bazën e të cilave janë bërë edhe përlllogaritjet

financiare për koston e zbatimit. Gjithashtu është menduar edhe hartimi i një kurrikule për edukimin mjedisor, i cili është ende në proces. Për sa i përket elementit mjedisor, janë menduar një sërë aktivitete ku fëmijët vizitojnë zona të mbrojtura mjedisore dhe zhvillojnë aktivitete në këto zona. Me asistencën e ekspertëve janë parashikuar edhe kostot e nevojshme për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Sporti dhe mirëqenia

Fusha tematike e Sportit përqendrohet te programet e vetë-mbrojtjes, duke marrë parasysh që programi i KOKSH-it për vitin 2022, parashikon angazhimin e të rinjve të gjithë arsimit parauniversitar në disiplinat e basketbollit dhe volejbollit. Kësisoj, është menduar me vlerë përfshirja e pjesëmarrësve nga arsimit i mesëm dhe i mesëm i lartë në programin e vetë-mbrojtjes, që kombinojnë artet marciale Aikido me parandalimin e dhunës, vetëpërmbytjen emocionale dhe aftësitë e komunikimit.

Statusi aktual: Programi është dërguar për miratim tek Ministria e Arsimit dhe Sportit. Me dt. 14.09.2022 është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM për miratimin e paketës dhe për përdorimin e fondit të kontigjencës për programin përkatës (VKM e përgatitur nga MAS)

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, në muajin prill 2022 filloi puna përgatitore për hapjen e Thirrjes së Shtatë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës dhe përgatitja e draft-metodologjisë dhe planit të veprimit.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët miratoi Urdhrin nr.1, datë 11.05.2022 për: Ngritjen e grupit të punës për realizimin e thirrjes së shtatë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, me anë të të cilit ngriti grupin e punës të përbërë nga:

Znj. A.T, MSHRF – Kryetar

Znj. D.T, MSHRF – Anëtar

Znj. J.B, MSHRF – Anëtar

Znj. J.Sh., AKR – Anëtar

Znj. E.H, AKR – Anëtar

Grupi i punës mbledhet me ftesë të kryetarit, jo më pak se 2 herë në muaj.

Grupit të auditimit i janë paraqitur minutat e takimit të zhvilluara nga grupi i punës të cilat janë të pa firmosura nga grupi i punës.

Me shkresën nr.2740/1 prot. datë 12.05.2022, Drejtori i Kabinetit të Ministrisë së Rinisë dhe Fëmijëve ka përcjellë Urdhrin e Ministrit të Rinisë dhe Fëmijëve me nr.1, datë 11.05.2022 pranë Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

Me shkresën nr.3079 prot. datë 27.05.2022 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët miratoi Urdhrin nr.2, datë 27.05.2022 për: Shpalljen e “Thirrjes së shtatë” në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, sipas planit të veprimit dhe metodologjisë për vitin 2022, që përcakton shpalljen për thirrjen e radhës, afatin për aplikim, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.

Me shkresën nr.3200 prot. datë 02.06.2022 dhe shkresën nr.3446 prot. datë 14.06.2022, me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të hapjes së thirrjes së VII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës”, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka kërkuar bashkëpunimin e institucioneve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor, institucioneve të tjera publike, njësisive të vetëqeverisjes vendore, shoqërive tregtare dhe organizatave jofitimprurëse

për të caktuar një person kontakti për ndjekjen e programit, për të konfirmuar numrin e praktikantëve, si dhe profilet e tyre studimore.

Me shkresën nr.3666 prot. datë 23.06.2022, me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim për aktivizimin e menaxhimit të portalit në kuadër të hapjes së thirrjes së VII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës”, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët kërkon nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ofrimin e shërbimit për aktivizimin e platformës online <https://praktika.rinia.gov.al>, e cila do të shërbejë shpalljen e thirrjes, publikimin e materialeve informuese, publikimin e profileve studimore të kërkuara, si dhe mundësimin e aplikimit online për të gjithë të rinjtë e interesuar.

Procesi i aplikimit zgjati nga data 1 korrik 2022 deri më 31 korrik 2022 (me një shtyrje deri me datë 10 gusht për arsye të problemeve me sistemin), ndërkohë që kohëzgjatja e praktikave planifikohet të jetë për 3 mujore nga 12 shtator 2022 deri më 12 dhjetor 2022. Pas përfundimit të programit, të rinjtë e vlerësuar me performancën më të mirë, në varësi edhe të pozicioneve të ofruara, do të lidhin kontratat e punësimit 1-vjeçare pranë institucioneve përkatëse.

Programi i kodimit për fëmijët e klasave të para.

Në përmbushje të kompetencave të tij për zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës në shkollë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është ngarkuar përmes Urdhrit nr. 151, datë 30.12.2021 të Kryeministrit për “Ngritjen e grupit ndërinstucional të punës për kurrikulën e kodimit që në klasë të parë për projektin “Analiza e situatës aktuale dhe propozimi i kurrikulave të përditësuara për lëndën e kodimit në arsimin parauniversitar”, të kryesojë Grupin Ndërinstucional të Punës dhe të bashkëveprojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për të ndërmarrë procesin e analizës së situatës të kurrikulave të lëndës së TIK-ut në arsimin parauniversitar dhe përditësimin e kurrikulave ekzistuese në mënyrë bashkëkohore.

Me qëllim plotësimin e këtyre nevojave dhe realizimin e objektivit për zbatimin e programit të TIK-ut që në klasë të parë, duke mbajtur në konsideratë dhe angazhimin dhe punën paraprake gjatë fazës I, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka udhëhequr procesin e konsultimit dhe bashkëpunimit me Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, AADF për bashkëfinancimin e kësaj nisme.

Grupi ndërinstucional i punës të thirret nga kryetari dhe të mblidhet çdo muaj ose sa herë që të vlerësohet e nevojshme, në varësi të problematikave të lindura në kuadër të procesit të analizës, të reformimit e të shtimit të kurrikulës së TIK-ut që në klasë të parë, sipas këtij urdhri. Me anë të shkresës nr.3012 Prot. datë 24.05.2022 me lëndë: Përcillet kurrikula e plotë e programit të lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për klasat e para për projektin “Analiza e situatës aktuale dhe propozimi i kurrikulave të përditësuara për lëndën e kodimit në arsimin parauniversitar”, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i përcjell Ministrin të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për dijeni Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, kurrikulën e plotë të lëndës së teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

Nga auditimi u konstatua se mungojnë mbledhjet e grupit.

Aktualisht është finalizuar miratimi i memorandumit të mirëkuptimit midis Këshillit të Ministrave dhe AADF-së që do ti hapë rrugë ndërtimit të 100 laboratorëve kompjuterike në 100 shkolla fillore të vendit, sigurimin e ekspertizës kombëtare dhe ndërkombëtare për hartimin e kurrikulës TIK për klasat I, II dhe III të shkollave fillore publike, trajnimin e mësuesve të TIK-ut për katër vite dhe prokurimin e platformës online për të mbështetur mësimdhënien.

Nga auditimi u konstatua se në zbatim të ligjit nr. 75, Datë 04.11.2019 “Për Rininë” dhe VKM nr. 524, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët”, përgjatë një viti pune që nga krijimi i Ministrisë dhe për periudhën objekt auditimi, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk është ndërmarrë asnjë hap mbi zhvillimin e disa nga kompetencave shumë të rëndësishme si hartimi dhe publikimi i raporteve të vlerësimit të situatës së të rinjve, monitorimi i politikave dhe veprimtarive rinore monitorimi i standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore sipas nenit 5, të ligjit, ku citohet:

Ministria përgjegjëse për rininë ka këto kompetenca:

c) harton dhe publikon raportet e vlerësimit mbi situatën e të rinjve;

ç) monitoron zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore;

d) monitoron standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë”;

Gjithashtu zbatimin e VKM-së nr. 524, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët” në pikën 3 dhe 4:

3. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton, zhvillon dhe monitoron politikën, për:

a) mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse;

dh) programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.

4. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, zhvillon dhe monitoron politikën, për:

d) marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës;

dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;

e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Titulli i gjetjes	<i>Veprimtaria e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët</i>
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk janë ndërmarrë hapa për zhvillimin e kompetencave të rëndësishme për hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit mbi situatën e të rinjve; zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore; nuk janë monitoruar standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë, të parashikuara në Ligjin nr.75/2019 “Për Rininë” neni 5.</p> <p>Gjithashtu nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk janë hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikën, për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, nuk ka hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikën, për marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës; sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit, në zbatimin të VKM-së nr. 524, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët” pikat 3 dhe 4.</p>

Kriteri:	<i>Ligji nr. 75, Datë 04.11.2019 “Për Rininë” VKM nr. 524, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët”</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos zhvillimi i kompetencave më të rëndësishme të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët si fushë e përgjegjesisë së tij ndikon në vlerësimin e situatës aktuale të të rinjve dhe fëmijëve në Shqipëri.
Shkaku:	Mos hartimi i raporteve të vlerësimit mbi situatën e të rinjve; Mos monitorimi i zbatimit të politikave, si dhe të veprimtarive rinore si dhe mos Monitorimi i standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të merren masa të menjëhershme lidhur me hartimin dhe publikimi i raporteve të vlerësimit të situatës së të rinjve, monitorimi i politikave dhe veprimtarive rinore, monitorimi i standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore duke dhënë në këtë mënyrë një vlerësim aktual mbi situatën reale të të rinjve në Republikën e Shqipërisë.

2.2. AKTIVITETI I AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

2.2.1 MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm 2021-2023 dhe PBA-në 2022-2024;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2021 dhe vitin 2022, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;
- 3) Raportet e monitorimit të realizimit të buxhetit.

a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Me VKM nr.681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, është krijuar institucioni i Agjencisë Kombëtare të Rinisë, të cilës i ka kaluar numri i punonjësve, buxhetin e planifikuar dhe të gjitha asetet e Shërbimit Kombëtar për Rininë. Agjencia Kombëtare e Rinisë është person juridik publik buxhetor, në varësi të Ministrit Përgjegjës për Rininë. AKR disponon një fond buxheti i cili përcaktohet në buxhetin vjetor të shtetit. AKR-ja mund të përdorë dhe burime të tjera financimi si donacionet apo sponsorizimet për realizimin e politikave, programeve dhe projekteve rinore. Nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, AKR-ja financon projektet e propozuara nga organizatat rinore, dhe/ose për të rinjtë apo njësitë e vetëqeverisjes vendore. Buxheti i AKR-së miratohet nga Ministrit Përgjegjës për Rininë.

Për vitin 2021, buxheti i miratuar për SHKR-në, është paraqitur në një program buxhetor i cili i është akorduar nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, programi Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë, me kod 08140.

Për vitin 2022, buxheti i miratuar për AKR-në paraqitet në një program buxhetor, programi për “Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët”, me kod 08610.

AKR-ja, si njësi e qeverisjes qendrore, duhet të përgatisë kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm, me qëllim që të sigurojë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet dhe objektivat e dokumenteve strategjik të vendit, si dhe Programin e Qeverisë gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare), duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave të politikës së programit.

Grupi i auditimit ka konstatuar se AKR-ja nuk ka përgatitur dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, të cilat duhet të shoqërohen me formatet e raporteve të PBA-së, si dhe Projekt Buxhetin e vitit 2021 dhe vitin 2022 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së”, pika 1.7 ku citohet ... “Çdo njësi e qeverisjes qendrore përgatit kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm, me qëllim që të

sigurojë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet dhe objektivat e dokumenteve strategjik të vendit, si dhe Programin e Qeverisë gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare) duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave të politikës së programit. Është e rëndësishme të mbahet parasysh që përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm si dhe, që buxheti vjetor do të jetë viti i parë i këtij programi.”

Rrjedhimisht, nga institucioni i AKR-së nuk është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-së, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së”, paragrafi 2.5, pika 1/a, në njësitë shpenzuese të nivelit të dytë që zbatojnë një program buxhetor të vetëm, drejtues programi, si rregull, është respektivisht nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në paragrafin 2.5, pika 2, citohet se: “...Drejtnesit e programit janë përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore”.

Në zbatim të udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018, paragrafi 2.5, pika 5, citohet se “...Drejtnesi i programit (Drejtori i Përgjithshëm) dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj.”, e cila nuk ka funksionuar.

b) Zbatimi i kritereve në realizimi i planit të buxhetit.

Detajimi i limitit mujor të fondeve të AKR-së është bërë mbështetur në ligjin nr. 137, datë 16.12.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore” dhe të Udhëzimit nr.22 dt.17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, UMF nr. 4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, UMF nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.

Viti 2021

Me shkresën nr.23724/62 prot., datë 14.01.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, për dijeni të MASR detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente për vitet 2021-2023.

Me shkresën 281/1 prot., datë 18.01.2021 protokolluar në SHKR me nr.11 prot., datë 22.01.2021, MASR ka dërguar në Shërbimin Kombëtar për Rininë detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente të miratuara.

Me shkresën nr.4564/1 prot., datë 11.03.2021 protokolluar në MASR me nr.1041/2 prot., datë 25.01.2022, MFE i ka dërguar Degës së Thesarit Tiranë, për dijeni të MASR, transferimin e fondeve për vitin 2021, ku sa i takon AKR-së, i është pakësuar fondi me 10,000 mijë lekë.

Shpenzimet e AKR-së në total për vitin 2021, ishin planifikuar në shumën 93,667 mijë lekë. Ato janë realizuar në vlerën 75,188 mijë lekë, ose 18,479 mijë lekë më pak se parashikimi.

Më poshtë paraqitet tabela e shpenzimeve për vitin 2021:

Analiza e shpenzimeve të realizuara nga aktiviteti i AKR-së për vitin 2021

Në lekë

Nr	Artikulli	Emërtimi i shpenzimeve	Plan	Fakt	% realizimit
1	600	Paga	20,300,000	15,130,096	74.5%
2	601	Sigurime Shoqërore	3,369,300	2,482,237	73.7%
3	602	Mallra dhe shërbime	6,600,000	3,549,377	53.8%
4	604	Transferata korrente të brendshme	42,998,000	33,641,843	78.2%
5	605	Transferimet korrente me jashtë vendit	20,400,000	20,384,500	99.9%
		Totali	93,667,800	75,188,053	80.3%

Burimi: AKR, përpunuar nga grupi i auditimit

Zërat e shpenzimeve për pagën e punonjësve dhe sigurimeve shoqërore janë realizuar respektivisht në masën 74.5% dhe 73.7%, e cila ka ardhur për arsye të mosplotësimit të strukturës.

Shuma e planifikuar për artikullin 602- Mallra dhe Shërbime është 6,600 mijë lekë, dhe është realizuar 3,549 mijë lekë, ose 53.8% si rrjedhojë e mos kryerjes të pagesave të planifikuara.

-Llogaria 604 - Transferta korrente të brendshme përfshin shumën e granteve që AKR transferon me qëllimin e realizimit të projekteve të financuara nga thirrja nr.1. Shuma e planifikuar është 42,998 lekë, por është realizuar 78.2% për shkak të mosarritjes të shlyerjes të të gjitha kësteve të planifikuara në kontratat e lidhura me Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore dhe Organizatave Jo Fitimprurëse.

-Llogaria 605 - Transferta korrente me jashtë vendit përfshin detyrimin vjetor që Qeveria Shqiptare ka për Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), e cila është bazuar në ligjin nr.118/116 datë 10.11.2021, neni 35, 36 dhe 44. Kjo kuotë mbart shumën prej 173,000 Euro, ekuivalente me shumën prej 384 mijë lekë.

Viti 2022

Totali i Buxhetit të Miratuar për AKR-në në vitin 2022 është 110,218,250 lekë.

Me shkresën nr.22922/7 prot., datë 29.12.2021 protokolluar në AKR nr.416 prot., datë 31.12.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar në AKR detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale për vitet 2022-2024.

Me shkresën 22922/123 prot., datë 18.01.2022 protokolluar në AKR nr.11 prot., datë 20.01.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar në Drejtorinë e Thesarit detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente.

Me shkresën nr.22922/145 prot., datë 24.01.2022 protokolluar në AKR me nr.13 prot., datë 25.01.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit i ka dërguar Degës së Thesarit Tiranë detajimin e limitit mujor për AKR.

Me shkresën nr.4934/3 prot. datë 17.03.2022 protokolluar në AKR me nr.75 prot., datë 24.03.2022, MFE ka dërguar në AKR detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ Nr.3, datë 12.03.2022.

Me shkresën nr.22922/252 prot., datë 04.04.2022 protokolluar në AKR nr.106 prot., datë 11.04.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar në Drejtorinë e Thesarit detajimin e buxhetit për shpenzimet kapitale.

Me shkresën nr.4934/111 prot., datë 04.04.2022 protokolluar në AKR me nr.107 prot., datë 11.04.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka miratuar limitin duke autorizuar shtesat e zërit "Shpenzime personeli" dhe pikësimet e zërit "Shpenzime Operative.

Shpenzimet e AKR-së në total për vitin 2022, janë planifikuar në shumën 110,218 mijë lekë. Deri më 31.08.2022, ato janë realizuar në vlerën 41,337 mijë lekë, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Artikulli	Emërtimi i shpenzimeve	Plan	Fakt deri më 31.08.2022	% realizimit
1	600	Paga	19,792,500	10,667,414	53.9%
2	601	Sigurime Shoqërore	3,285,750	1,681,193	51.2%
3	602	Mallra dhe shërbime	5,940,000	3,174,508	53.4%
4	604	Transferta korrente të brendshme	60,700,000	8,229,460	13.6%
5	605	Transferimet korrente me jashtë vendit	20,500,000	17,574,000	85.7%
		Totali	110,218,250	41,326,575	37%

Burimi: AKR, përpunuar nga grupi i auditimit

Raportet e monitorimit

Nga auditimi konstatohet se, për periudhën objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të AKR-së, të cilat dërgohen në ministrinë e linjës.

AKR financohet nga buxheti i shtetit për programin Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët.

Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit me financim të brendshëm konsistojnë në rakordimet që AKR-ja bën me Ministrinë e linjës për rininë për arritjen e objektivave për të cilat alokohen këto fonde.

Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12-mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenonjë monitorimin e performancës financiare, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mungesa e hartimit të dokumentit të PBA-së dhe e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore</i>
Situata	<p>-Nga auditimi konstatohet se, AKR-ja nuk ka përgatitur dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, formatet e raporteve të PBA-së, si dhe nuk ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 1.5 dhe paragrafi 2.5 pika 1/a, paragrafi 2.5 pika 5.</p> <p>- Nga auditimi konstatohet se, për periudhën objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12-mujore të buxhetit. AKR-ja financohet nga buxheti i shtetit për programin Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit me financim të brendshëm konsistojnë në rakordimet që AKR-ja bën me Ministrinë e linjës për rininë për arritjen e objektivave për të cilat alokohen këto fonde. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12-mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenonjë monitorimin e performancës financiare, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr.9, date 20.3.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore” dhe të Udhëzimit nr.22 dt.17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”</p>
Kriteri:	Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat Standarde të përgatitjes së Programeve Buxhetore Afatmesme”.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e raporteve të monitorimit të buxhetit nuk bën të mundur ndjekjen e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar nga institucioni
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse. Formatet e hartimit të PBA-së nuk janë plotësuar nga struktura përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<p>- Titullari i institucionit të AKR-së të marrë masa për krijimin Ekipin e Menaxhimit të Programit, hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm së bashku me formatet e raporteve të PBA-së, çdo vit, me qëllim për të mundur një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.</p> <p>- AKR-ja të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 4-8-12-mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore.</p>

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

2.2.2 ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Në zbatim të programit të auditimit nr. 791/3 prot., datë 15.09.2022, mbi “Auditimin e përputhshmërisë në Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë”, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1.Struktura organizative e AKR-së;

- 2.Procedurat e ndjekura për emërimet, largimet, vendimmarrjet përkatëse dhe zbatimin e strukturave organizative për periudhën 01.01.2021 - 31.08.2022;
- 3.Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;
- 4.Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës për periudhën 01.01.2021 - 31.08.2022;
- 5.Listëpagesat mujore për periudhën 01.01.2021 - 31.08.2022.

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Struktura organizative

Agjencia Kombëtare e Rinisë është institucioni që ka për detyrë të zbatojë politikat dhe programet për të rinjtë.


Organika dhe struktura e AKR-së miratohet me Urdhër të Kryeministrit, me propozim të AKR-së, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Me VKM nr.681, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” u krijua Agjencia Kombëtare e Rinisë, e cila deri në këtë moment ka funksionuar si Shërbimi Kombëtar i Rinisë.

AKR-ja kryen funksionet e saj me një numër të përgjithshëm punonjësish, gjithsej 20 punonjës, duke u bazuar në organigramën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 163, datë 14.12.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë”. Sipas kësaj strukture, AKR-ja është e organizuar mbi bazën e tre sektorëve: Sektori i Projekteve Rinore, Sektori i Programeve, Bashkëpunimit dhe Statistikës, si dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Organigrama e AKR-së ka funksionuar si më poshtë:



Burimi: AKR

Gjatë periudhës objekt auditimi, në AKR kanë ndodhur ndryshime në strukturë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve.

b. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna

Emërimet

Procedura e rekrutimit të stafit në AKR është realizuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Pranimi nga detyra e punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, bazuar në rregulloren e brendshme.

Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve për vendet e lira të punës, ngrihet me urdhër të Drejtorit të AKR-së, i cili vlerëson të gjithë kandidatët konkurrues për vendin e shpallur. AKR dërgon

njoftimin për vendet e lira të punës pranë APP për t'i publikuar tek Buletini i Prokurimit Publik. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 3 ditë nga shpallja.

Pas mbylljes së aplikimeve, Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve për vendet e lira të punës shqyrton dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët, dhe mban një procesverbal mbi vlerësimin e aplikantëve. Më pas, secili nga kandidatët njoftohet nëpërmjet postës elektronike për datën dhe orën e intervistës. Anëtarët e komisionit kryejnë një vlerësim individual me pikë për dokumentacionin e dorëzuar dhe intervistimin e secilit kandidat duke vendosur pikët përkatëse.

Komisioni i vlerësimit të kandidatëve në përfundim të gjithë procesit të vlerësimit i dërgon Drejtorit të Përgjithshëm një memo me vlerësimet e komisionit (vlerësim mesatar për secilin kandidat). Pasi merret miratimi nga Drejtori i përgjithshëm kryhet emërimi i kandidatit me pikë më të larta.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, në AKR janë emëruar gjithsej 19 punonjës.

Për periudhën 01.01.2022 - 31.08.2022, në AKR janë emëruar gjithsej 5 punonjës.

Largimet

Për periudhën objekt auditimi, AKR-ja ka patur gjithsej 13 largime punonjësish.

Për periudhën nga 01.01.2021 - 31.12.2021, janë larguar 6 punonjës me dorëheqje dhe një punonjës me shkarkim.

Për periudhën 01.01.2022 - 31.08.2022, janë larguar 6 punonjës me dorëheqje.

Pas paraqitjes së dorëheqjes nga punonjësi me shkrim, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin e lirimimit nga detyra.

Në rastin me shkarkim Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin e shkarkimit nga detyra.

c. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve

Dosjet e personelit

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse, sipas strukturës së Agjencia Kombëtare e Rinisë, duke u bazuar në VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, e cila përcakton se:

1. *Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.*

2. *Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrive, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.*

Sa i përket dokumenteve që duhet të jenë në dosjet e të punësuarve, baza ligjore në fuqi përcakton se:

Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

-Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar.

-Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes.

-Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë); certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjisllacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse “nota mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga

institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i laurimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfituar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës; akti i dhënies së masës disiplinore; librezat e punës; raportit i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 10 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi.

Dosjet e personelit duke u bazuar në VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit, janë konstatuar mangësitë si më poshtë:

- në të gjitha dosjet mungon fleta e inventarit, fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, kontrata individuale e punës dhe vlerësimi periodik i performancës.

- në disa dosje mungon librezat e punës ose është e paplotësuar me datën e fillimit të punës, lista e notave, dëshmia e penalitetit, si dhe dokumentacioni i bashkangjitur në dosje është i pa noterizuar;

Në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, dokumentacioni në dosjet e personelit nuk është i plotë.

Titulli i gjetjes	<i>Mangësi dokumentacioni në dosjet e personelit</i>
Situata:	Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse, duke ju referuar VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit, janë konstatuar mangësitë si më poshtë: Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit; dosjet e personelit shoqërohen nga fleta e inventarit; kontrata individuale e punës; vlerësimi periodik i performancës; dokumentacion të panoterizuar; librezat e punës e paplotësuar me datën e fillimit të punës; lista e notave; Dëshmi penaliteti., veprime në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
Kriteri:	- VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, - Urdhri të Ministrit të Ministrisë Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 103, datë 06.03.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi sjell që dokumentacioni në dosjet personale të punonjësve nuk është i plotë.
Shkaku:	Përgjegjësi e Sektorit të Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Kontratat e punës

Në zbatim të pikës 6, të VKM nr.681, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencinë Kombëtare të Rinisë rregullohen nga dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11 pika 1 ku përcaktohet se:

Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:

a. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; b. Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë; c. Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore; d. Kontrata kolektive e punës e. Kontrata individuale e punës; f. Rregullorja e brendshme; g. Zakonet lokale dhe profesionale.

Titulli i gjetjes:	<i>Mungesë e formatit tip të Kontratës Individuale të Punës</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua se AKR-ja nuk ka lidhur një Kontratë Individuale të Punës me secilin nga punonjësit e institucionit, si dhe nuk ka një kontratë tip , ku të përcaktohen të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punë si: a. identitetin e palëve; b. vendin e punës; c. përshkrimin e përgjithshëm të punës; d. datën e fillimit të punës; e. kohëzgjatjen kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; f. kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; g. afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; h. elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; i. kohën normale javore të punës; j. kontrata e punës duhet të përmbajë dhe kontratën kolektive. Ky veprim është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11 pika 1 dhe neni 21 pika 3
Kriteri:	-Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; -VKM nr.681, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi
Shkaku:	Mungesa e Kontratës Individuale të Punës
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që të hartojë një format tip që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës dhe të lidhë Kontrata Individuale të Punës me secilin nga punonjësit e institucionit.

Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga strukturat përkatëse pranë AKR-së, u konstatua se për periudhën e auditimit ka patur 3 çështje gjyqësore lidhur me marrëdhëniet e punës.

Për periudhën Janar 2021 - Gusht 2022, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ka qenë palë e paditur, në çështjet civile me objekt “Dëmshpërblimin e punonjësve të Qendrës Rajonale Rinore Vlorë të Shërbimit Kombëtar Rinor, për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të marrëdhënies së punës” dhe më konkretisht:

- Znj. S.H. ka depozituar kërkesëpadinë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt detyrimin e palës së paditur (AKR-së) për dëmshpërblimin e paditëses me disa rroga për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të marrëdhënies së punës. Gjykata e Vlorës me Vendimin Nr. 2568 datë 25.10.2021, ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesë padisë duke dhënë vendimin me ekzekutim të përkohshëm. Prej kësaj date, përmbaruesi gjyqësor ka nisur shkresat për likuidimin vullnetar të detyrimit që ngarkohet nga Vendimi Nr. 2568/2021. AKR-ja është duke bërë kalimin e kësteve sipas detyrimeve që përcakton Kodi i Procedurës Civile për ekzekutimin e përkohshëm të vendimit si dhe ka depozituar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ankimin kundër këtij vendimi.
- Znj. A.I. ka depozituar kërkesëpadinë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt detyrimin e palës së paditur (AKR-së) për dëmshpërblimin e paditëses me disa rroga për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të marrëdhënies së punës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin Nr. 2894 datë 21.12.2021 ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesë padisë dhe AKR-ja menjëherë pas vënies në dijeni të Vendimit ka ushtruar të drejtën e ankimit. Ende nuk është zhvilluar asnjë seancë dhe nuk ka komunikim për datën e gjyqit në Gjykatën e Apelit Vlorë.

- Znj. J.M. ka depozituar kërkesëpadinë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt detyrimin e palës së paditur (AKR-së) për dëmshpërblimin e paditëses me disa rroga për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të marrëdhënies së punës. Janë zhvilluar dy seanca në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, ku janë bërë parashtrimet përkatëse për rrëzimin e kërkesë padisë nga ana e AKR-së dhe është ende i pambyllur me vendim ky proces gjyqësor.

AKR-ja nuk është palë e paditur dhe as paditëse në asnjë proces tjetër.

Marrëdhëniet e pagave

Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve Janar, Korrik dhe Dhjetor 2021, si dhe Janar, Qershor 2022. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se përlllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listëprezencat në punë, të përgatitura nga Drejtorët e çdo drejtorie dhe përgjegjësit respektivë, si dhe janë nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së.

Në sektorin e financës, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05,1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 8438, datë 28.12,1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Titulli i gjetjes:	<i>Rregullorja e Brendshme e AKR-së nuk është e përditësuar me bazën ligjore në fuqi</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e Brendshme e institucionit është miratuar me Urdhër të Ministrit të MASR nr. 103, datë 06.03.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Kombëtar për Rininë”. Me VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, është krijuar institucioni i AKR-së, të cilës i ka kaluar numri i punonjësve, buxheti i planifikuar dhe të gjitha asetet e Shërbimit Kombëtar për Rininë. Dhe pse kanë ndodhur këto ndryshime, AKR vazhdon të funksionojë sipas kësaj rregullore, e cila nuk është përditësuar me bazën ligjore në fuqi. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr.681, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, ku citohet... “5.Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKR-së miratohet nga ministri, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.” dhe “6...Pranimi dhe lirimi nga detyra e punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, mbi bazën e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKR-së.”
Kriteri:	-VKM nr.681, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”; -Urdhri të Ministrit të Ministrisë Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 103, datë 06.03.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.
Ndikimi/Efekti:	Rregullorja aktuale nuk është koherente me strukturën organike në fuqi.
Shkaku:	Mos koherenca midis strukturës dhe rregullores krijon vështirësi në punën e institucionit të AKR-së.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të marrin masa për përditësimin e rregullores për funksionimin sipas ndryshimeve të ndodhura në organikën dhe strukturën e AKR-së.

2.2.3 INVENTARIZIMI I PRONËS SHTETËRORE, NXJERRJA E REZULTATEVE TË INVENTARIZIMIT DHE SISTEMIMI I DIFERENCAVE NË PËRPTHJE ME RREGULLAT KONTABËL

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Inventarizimi i vitit 2021

Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare Rinisë për vitin 2021, ka ngritur komisionin me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 80, datë 31.12.2021 “Për kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë” duke bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit.

Më shkresën nr.422/1 datë 15.01.2022 me lëndë “Relacion mbi inventarizimit e aktiveve 2021”, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar se nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet.

Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30 të MFE datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

2.2.4 PROJEKTET RINORE TË PËRFITUARA NGA ORGANIZATAT RINORE DHE/OSE PËR TË RINJTË SI DHE NGA NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Procesi i shpalljes së Thirrjes Nr. 1 për projekt propozime nga Organizatat Rinore dhe/ose për të Rinjtë si dhe nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, është mbështetur në Ligjin Nr. 75/2019 “*Për rininë*” si dhe Vendimin nr. 1141, datë 24.12.2020 “*Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë*”.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ka bërë shpalljen e thirrjes në faqen e saj zyrtare më datë 28.06.2021, duke publikuar të gjithë paketën e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim. Thirrja nr.1 për projekt propozime rinore u hap në datën 28 Qershor 2021 deri më 12 Gusht 2021. Kjo thirrje pati një numër total prej 95 aplikimesh, respektivisht 66 projekt propozime nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë dhe 29 projekt propozime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKR-së Nr. 34 datë 28.06.2021, u ngrit Grupi I Punës me përbërje : I.L, B.D, I.V, B.S dhe J.Sh., për shqyrtimin e dokumentacionit për secilin aplikant, me pas shqyrtimit të të cilave, i është dërguar Bordit Përzgjedhës të Projekteve, lista me kandidatët që i përmbushnin dokumentacionin ligjor të aplikimit. Bordi Përzgjedhës është ngritur me Urdhrin e Ministrisë të Arsimit, Rinisë dhe Sportit Nr. 168 datë 18.06.2021 “Për ngritjen e Bordit Përzgjedhës të Projekteve që përfitojnë mbështetje financiare nëpërmjet fondit grant të dedikuar për Rininë” me përbërje: B.M, K.K, O.B, E.B, E.K. Funkcionet e këtij Bordi ishin përzgjedhja e projekteve bazuar në kapacitetin e aplikantit, lidhjen me fushat e synuara, efektshmërinë e buxhetit, pritshmërinë dhe vizibilitetin e aktiviteteve.

Pas dërgimit të procesverbalit të Bordit Përzgjedhës të Projekteve, datë 27/09/2021, AKR-ja ka nisur negociimin e buxhetit me aplikantët. Përgjatë muajit nëntor janë nënshkruar kontratat me aplikantët fitues dhe sipas kësaj të fundit, është bërë nga ana e AKR-së kalimi i kështit të parë (përkatësisht 50% e buxhetit për OJF-të dhe 90% për NJVV-të.)

Në vijim janë caktuar personat përgjegjës për monitorimin e secilës Organizatë dhe NJVV me Urdhrin nr.60, datë 22.11.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i AKR. Monitorimi është kryer përmes komunikimeve elektronike dhe vizitave në terren dhe vijon të jetë në proces, deri në përfundim të projekteve.

Procesi i monitorimit nuk është I dokumentuar .

Nga Thirrja nr. 1, Agjencia Kombëtare e Rinisë ka mbështetur realizimin e projekteve në 4 njësi të vetëqeverisjes vendore.

Bashkia Tiranë

Bashkia Tiranë ka aplikuar për thirrjen për Rininë në kuadër të thirrjes për financim të projekteve nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, (shkresa nuk përmban numër protokollit dhe datë) për projektin: “Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për të Rinjtë, Petrelë”.

Është mbajtur procesverbali në datën 10.09.2021 mbi vlerësimin e aplikimeve nga subjektet konkurruese dhe janë përzgjedhur subjektet që përmbushin kriteret dhe kalimin në fazën e dytë të vlerësimit 23 projekt propozime nga 29 aplikime gjithsej.

Në datën 27.09.2021, është mbajtur procesverbali nga Bordi Përzgjedhës i Projekteve mbi kualifikimin përfundimtar të projekt propozimeve.

Nga auditimi konstatohet se Preventivi i punimeve nuk përmban as firmë dhe as vulë.

Gjithashtu shkresa për shprehje interesi është e pa protokolluar si dhe formulari i aplikimit është vetëm i firmosur dhe jo i vulosur në çdo faqe të tij sipas kërkesave.

Është lidhur kontrata me nr.363, datë 23.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Bashkisë Tiranë, me vlerë financimi nga AKR 3,186,489 lekë, me afat 12 mujor .

Kësti i parë prej 90% është likuiduar me urdhër shpenzimit nr.93, datë 16.12.2021, në vlerën 2,867,840 lekë.

Bashkia Tiranë nuk ka filluar ende implementimin e projektit 12 mujor, “Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për të Rinjtë, Petrelë”.

Nga AKR nuk ka asnjë dokumentacion mbi monitorimin e zhvillimit të projektit.

Observacion i subjektit mbi Projektraportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 20.12.2022 me nr.475/1. prot.

Pretendimi i Subjektit: Lidhur me Bashkinë Tiranë, Ju informojmë se ka nisur implementimin e projektit “Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për të Rinjtë Petrelë”. Procedura e prokurimit është shpallur nga autoriteti kontraktues dhe është mbyllur në datë 08.08.2022. Operatori fitues është shpallur L.T shpk Kontrata e nënshkruar në Buletinin nr.131, datë 26.09.2022. Në vijim Bashkia Tiranë ka dërguar shkresën me lëndë “Kërkesë për shtyrje kontrate”, miratuar nga AKR me nr.491, datë 06.12.2022.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Bashkia Tiranë ka lidhur kontratën me AKR në datën 23.11.2021, me afat 12 mujor, pra kontrata përfundon në datën 23.11.2022. Nga ana e AKR nuk ka asnjë informacion nëse punimet kanë nisur dhe çfarë faze janë , pra nuk ka asnjë dokument monitorimi. Koha për përfundimin e projektit është e pamjaftueshme dhe nga ana e Bashkisë tiranë është kërkuar një shtyrje e afatit të përfundimit të projektit jashtë afateve të përcaktuara në kontratë.

Observacioni nuk merret në konsideratë.

Bashkia Elbasan

Bashkia Elbasan ka shprehur interesin dhe ka aplikuar për thirrjen për Rininë në kuadër të thirrjes së parë me fokus në ndërtimin apo rikonstruksionin e objekteve publike dhe të infrastrukturës rinore nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për projektin “Talent St-Art-Up Elbasan 2”.

Kryetari i Bashkisë Elbasan me anë të shkresës nr.3770 prot. datë 10.08.2021 ka deleguar kompetencat me anë të Vendimit nr.730 datë 10.08.2021 Znj. V.L me detyrë zv. Kryetare Bashkie të nënshkruajë Projekt propozimin në përgjigje të thirrjes së parë të AKR.

Pas shpallje fitues nga Bordit Përzgjedhës të Projekteve, sipas procesverbalit të mbajtur më datë 27.09.2021, anëtarët e bordit vendosën bashkërisht rishikim i buxhetit te projekt

propozimeve. Me anë të procesverbalit më datë 14.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. I.L, përfaqësues AKR dhe z. A.Q, nën kryetar Bashkisë Elbasan diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit. Gjatë diskutimit palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Talent Start-Up Elbasan 2”, nga vlera fillestare e propozuar 8,497,392.92 lekë do reduktohet në vlerën 5,503,842 lekë. Është lidhur kontrata me nr.5374, protokolluar Bashkia Elbasan nr.301 prot., datë 03.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Bashkisë Elbasan, me vlerë financimi nga AKR 5,503,842 lekë, me afat 10 mujor.

Kësti i parë prej 90% është likuiduar me urdhër shpenzimit nr.76, datë 06.12.2021, në vlerën 4,953,485 lekë.

Bashkia Elbasan me anë të shkresës nr.3746 prot. më datë 02.08.2022, protokolluar pranë AKR me nr.230 prot. datë 23.08.2022 me lëndë Kërkesë për shtyrje afati projekti “Talent St-Art-Up Elbasan 2”, ku përfituesi ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik për blerjen e pajisjeve teknologjike objekt kontrate, procedurë e cila është zhvilluar tre herë dhe të tre herët është anuluar kryesisht për mosparaqitjen e ofertave të përshtatshme. Bashkia Elbasan ka kërkuar shtyrje të projektit prej 2 muaj, periudhë e cila do të jetë e nevojshme për përfundimin me sukses të procedurës së prokurimit dhe blerjes së pajisjeve. AKR me anë të shkresës nr.231 prot. datë 24.08.2022 me lëndë kthim përgjigje shkresë nr.3746 prot. datë 02.08.2022, AKR ka miratuar kërkesën për shtyrje e projektit me 2 muaj deri më 03.11.2022.

Bashkia Elbasan nuk ka filluar ende implementimin e projektit.

Nga AKR nuk ka asnjë dokumentacion mbi monitorimin e zhvillimit të projektit.

Observacion i subjektit mbi Projekt raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 20.12.2022 me nr.475/1. prot.

Pretendimi i Subjektit: Lidhur me Bashkinë Elbasan, Ju informojmë se Bashkia Elbasan nëpërmjet shkresës nr.4732/1 Prot, datë 02.11.2022 kërkon shtyrjen e afatit të implementimit të projektit dhe nisjen e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, qenë para faktit se procedura e prokurimit është zhvilluar 4 herë dhe është mbyllur pa sukses duke mos pasur asnjë ofertë të përshtatshme ose nuk ka pasur pjesëmarrje.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga ana e AKR është bërë një shtyrje e projektit me dy muaj deri në datën 03.11.2022. pra dhe brenda kësaj date nuk është bërë asgjë lidhur me fillimin e projektit.

Observacioni nuk meret në konsideratë.

Bashkia Roskovec

Bashkia Roskovec ka aplikuar për thirrjen për Rininë me shkresën nr.5543, datë 11.08.2021, në kuadër të thirrjes për financim të projekteve nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për projektin “Rikonstruksioni i Bibliotekës Publike Roskovec dhe krijimi i një Klubi Libri për të rinj”.

Është mbajtur procesverbali në datën 10.09.2021 mbi vlerësimin e aplikimeve nga subjektet konkurruese dhe janë përzgjedhur subjektet që përmbushin kriteret dhe kalimin në fazën e dytë të vlerësimit 23 projekt propozime nga 29 aplikime gjithsej.

Në datën 27.09.2021, është mbajtur procesverbali nga Bordi Përzgjedhës i Projekteve mbi kualifikimin përfundimtar të projektpropozimeve.

Është lidhur kontrata me nr.7247, datë 01.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Bashkisë Roskovec, me vlerë financimi nga AKR 1,905,443 lekë, me afat 6 mujor .

Kësti i parë prej 90% është likuiduar me urdhër shpenzimit nr.72, datë 0.11.2021, në vlerën 1,714,898 lekë.

Bashkia Roskovec ka përfunduar implementimin e projektit me titull “Rikonstruksioni i Bibliotekës Publike Roskovec dhe krijimi i një Klubi Libri për të rinj”.

Për arsye të kushteve atmosferike jo optimale, ky projekt, i parashikuar të zbatohet për 6 muaj, u shty një muaj në kohëzgjatje.

Bashkia Lezhë

Bashkia Lezhë ka aplikuar për thirrjen për Rininë me shkresën nr.14901 Prot. datë 12.08.2021, në kuadër të thirrjes për financim Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për projektin “Rikonstruksioni i Qendrës Rinore Lezhë”.

Është lidhur kontrata me nr.19199, datë 05.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Bashkisë Lezhë, me vlerë financimi nga AKR 8,541,077,6 lekë, me afat 12 mujor .

Kësti i parë prej 90% është likuiduar me urdhër shpenzimit nr.74, datë 11.11.2021, në vlerën 7,686,970 lekë.

Me shkresën nr.199 prot. datë 05.07.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së ka kërkuar informacion nga Bashkia Lezhë në lidhje me arsyet e vonesave të realizimit të kontratës.

Me shkresën nr.208 prot. datë 27.07.2022, Kryetari i Bashkisë Lezhë ka kthyer përgjigje në lidhje me zbatimin e kontratës, ku citon se aktualisht janë në fazën e liritimit të ambienteve të godinës, e cila do pasohet me procesin e investimit të zbatimit të projektit. Ndërkohë që procedura e tenderit për rikonstruksionin dhe mobilimin e ambienteve do të vazhdojë paralelisht. Sa më sipër, Bashkia Lezhë ka kërkuar që të amendohet kontrata nëse procesi i tenderimit nuk do të realizohet brenda afateve të parashikuara.

Me shkresën nr.220 prot. datë 08.08.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së ka kërkuar nga Bashkia Lezhë arsyet objektive që kanë sjellë mos realizimin e kontratës në kohë, si dhe afatin deri në të cilin duhet të shtyhet kontrata në referencë, nëse kjo shtyrje është e nevojshme.

Bashkia Lezhë nuk ka filluar ende implementimin e projektit.

Observacion i subjektit mbi Projektraportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 20.12.2022 me nr.475/1. prot.

Pretendimi i Subjektit: Lidhur me Bashkinë Lezhë, Ju informojmë se Bashkia Lezhë nëpërmjet shkresës nr.17936, datë 02.11.2022, protokolluar pranë AKR me nr.451, datë 04.11.2022, ka bërë nisjen e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i Qendrës Rinore Lezhë.”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga ana e AKR duhej të ishte kryer monitorimi i kësaj kontrate dhe arsyet se pse kanë çuar në këtë vonesë në kundërshtim me kontratën e lidhur.

Observacioni nuk meret në konsideratë.

Titulli i gjetjes	<i>Mbi auditimin e realizimit të projekteve në njësitë e vetëqeverisjes vendore.</i>
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se nga 4 projektet e fituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, 3 prej tyre në përfundim të afatit të kontratave nuk e kanë filluar ende implementimin e projekteve në kundërshtim me kontratat e lidhura. Përkatësisht 1-Bashkia Tiranë me projektin: “Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për të Rinjtë, Petrelë” ka lidhur kontratën nr.363, datë 23.11.2021, me vlerë financimi nga AKR 3,186,489 lekë, me afat 12 mujor . Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 2,867,840 lekë sipas kontratës.</p> <p>2-Bashkia Elbasan me projektin “Talent St-Art-Up Elbasan 2”, ka lidhur kontratën me nr.5374, datë 03.11.2021, vlerë financimi nga AKR 5,503,842 lekë, me afat 10 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 4,953,485 lekë sipas kontratës.</p> <p>3-Bashkia Lezhë me projektin “Rikonstruksioni i Qendrës Rinore Lezhë” ka lidhur kontratën me nr. 19199, datë 05.11.2021 vlerë financimi nga AKR 8,541,077,6 lekë, me afat 12 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 7,686,970 lekë sipas kontratës.</p> <p>Në këto kushte vlera e financuar nga AKR prej 15,508,295 lekë nuk është përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe efijencë, pasi konstatuam se projektet ende nuk kishin nisur fazën e implementimit në kundërshtim me kontratën.</p>
Kriteri:	<p><i>Ligji nr. 75, Datë 04.11.2019 “Për Rininë”</i></p> <p><i>VKM nr.681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”.</i></p>

Ndikimi/Efekti:	Projektet nuk kanë nisur ende fazën e implementimit dhe pse janë në përfundim të kontratës, në kundërshtim me afatin në kontratë, gjë e cila ka humbur dhënien e qëllimit të grantit. Vlera e grantit e përfituar përbën përdorim pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet nga subjektet Bashkia Tiranë, Bashkia Elbasan dhe Bashkia Lezhë.
Shkaku:	Mos fillimi implementimit të projekteve nga ana e Bashkive në kundërshtim me afatet e kontratave respektive.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga AKR të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos fillimin e implementimit të projekteve të bashkive, referuar kontratave së lidhur midis AKR-së dhe Bashkive Tiranë, Elbasan, Lezhë duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 15,508,295 lekë.

Nga Thirrja nr. 1, Agjencia Kombëtare e Rinisë ka mbështetur realizimin e 12 projekteve për organizatat, si më poshtë:

Organizata “S”

Organizata Qendra për edukim dhe sport “S” ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Sporti dhe Edukimi Frymëzojnë”, projekti do të implementohet në Bashkinë Cërrik (4 njësitë Administrative të Bashkisë)

Qëllimi i projektit është integrimi social për të rinjtë e Bashkisë Cërrik nëpërmjet ofrimit të aktiviteteve sportive dhe edukative edhe si një mënyrë për parandalimin e përfshirjes së tyre në krim dhe zakone të këqija.

Me anë të procesverbalit me datë 26.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. I.L., përfaqësues të AKR-së dhe z. A.B, përfaqësues i Organizatës Qendra për edukim dhe sport “S” diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Sporti dhe Edukimi Frymëzojnë”, nga vlera fillestare e propozuar 2,940,000 lekë do reduktohet në vlerën 1,518,000 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.319, datë 12.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Organizatës Qendra për edukim dhe sport “S”, me objekt zbatimin e projektit: “Sporti dhe Edukimi Frymëzojnë”, me vlerë financimi nga AKR 1,518,000 lekë, me afat 12 mujor.

Me Urdhrin nr.57 datë 18.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.80, datë 19.11.2021, në vlerën 759,000 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se dokumentacioni i mbajtur mbi monitorimin në terren për implementimin e projektit nuk ishte i plotë, pasi për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës.

A.I

Organizata “I.A” ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Youth 4 Entrepreneurship”, projekti do të implementohet në Qarkun e Vlorës, Shkodrës dhe Korçës.

Qëllimi i projektit është të nxisë vetëpunësimin dhe frymën sipërmarrëse tek të rinjtë e qarqeve të Vlorës, Shkodrës dhe Korçës si një formë për të parandaluar emigrimin dhe për të ulur normën e papunësisë e nivelet e kriminalitetit tek të rinjtë e këtyre qyteteve. Me anë të këtij projekti synohet që të rinjtë e qarqeve të Vlorës, Shkodrës dhe Korçës t’u ofrohet një mundësi për tu vetëpunësuar, për të ngritur biznese të suksesshme si dhe për të punësuar të rinj të tjerë.

Me anë të procesverbalit me datë 11.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. I.L., përfaqësues të AKR-së dhe znj. E.H, përfaqësues i Organizatës “I.A” diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Youth 4 Entrepreneurship”, nga vlera fillestare e propozuar 2,997,530 lekë do reduktohet në vlerën 2,832,530 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.310, datë 05.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Organizatës “I.A”, me objekt zbatimin e projektit: “Youth 4 Entrepreneurship”, me vlerë financimi nga AKR 2,832,530 lekë, me afat 12 muaj.

Me Urdhrin nr.58 datë 18.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të këstit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.80, datë 06.12.2021, në vlerën 1,416,265 lekë.

Kësti i parë është paguar rreth 1 muaj pas nënshkrimit të kontratës dhe jo 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës, në kundërshtim në nenin 5 të kontratës Mënyra e financimit të projektit (tabela e pagesave), ku përcaktohen dhe afatet për pagesën.

Grupi i auditimit konstatoi se dokumentacioni i mbajtur mbi monitorimin në terren për implementimin e projektit nuk ishte i plotë, pasi për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës.

Organizata “TheD”

Qendra “TheD” ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Duam më shumë natyrën dhe Shqipërinë”, projekti do të implementohet në Qarkun e Shkodrës dhe Elbasanit.

Qëllimi i projektit është fuqizimi i 30 të rinjve dhe të rejave për jetesën e pavarur dhe miqësore në natyrë si njohja me monumentet natyrore të vendit tonë, në territorin e Qarkut Shkodër dhe Qarkut të Elbasanit për përgjatë periudhës 9 mujore nga fillimi i zbatimit të projektit.

Me anë të procesverbalit me datë 13.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., z. G.G, përfaqësues të AKR-së dhe z. K.F, përfaqësues i Qendrës “TheD” diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Duam më shumë natyrën dhe Shqipërinë”, nga vlera fillestare e propozuar 2,999,900 lekë do reduktohet në vlerën 2,799,800 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.299, datë 02.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Qendrës “TheD”, me objekt zbatimin e projektit: “Duam më shumë natyrën dhe Shqipërinë”, me vlerë financimi nga AKR 2,799,800 lekë, me afat 9 muaj.

Me Urdhrin nr.48 datë 8.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të këstit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.71, datë 09.11.2021, në vlerën 1,399,900 lekë.

Përfituesi ka dërguar pranë AKR-së raportin financiar për periudhën 2.11.2021- 5.06.2022 (pa datë), dhe raportin përshkruar me datë 07.07.2022, në përputhje me nenin 7 të Kontratës. Me datë 01.08.2022, AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar dhe më 01.08.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkruar në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.47 datë 16.08.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të këstit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.64, datë 06.09.2022, në vlerën 1,119,920 lekë.

Qendra “TheD” ka dorëzuar shkresën më datë 27.07.2022, protokolluar pranë AKR me nr.212 prot. datë 01.08.2022 me lëndë Kërkesë për shtyrje afati. Ku deklaroi se përfituesi ka përfunduar të gjithë aktivitetet e parashikuara në projekt, por për arsye se janë në pritje të këstit të dytë, i cili ka patur vonesa për arsye teknike të sistemeve informatike, nuk janë bërë të gjitha pagesat. Në këto kushte kërkojnë shtyrje afati për pagesat e faturave deri më 31.08.2022. (Kërkesë e ardhur 5 ditë para përfundimit të kontratës dhe jo sipas nenit 13 të Kontratës ku citohet “... Zgjatja në kohë e projektit por edhe shkurtimi i tij ndodh vetëm pas një kërkesë nga Përfituesi, e dërguar të paktën 1 (një) muaj përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga AKR-ja...”).

AKR me anë të shkresës nr.221 prot. datë 08.08.2022 me lëndë kthim përgjigje kërkesës për shtyrje të afatit të zbatimit të Projektit “Duam më shumë natyrën dhe Shqipërinë”, ka miratuar kërkesën për shtyrje e projektit deri më 31.08.2022. Kësti i dytë është paguar pas këtij afati të shtyrë.

Grupi i auditimit konstatoi se dokumentacioni i mbajtur mbi monitorimin në terren për implementimin e projektit nuk ishte i plotë, pasi për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës.

Qendra “M.S”

Qendra “M.S” ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “We are all made of stars – formimi artistik dhe performancë në skenë për talentet e reja të Shqipërisë.”

Qëllimi i projektit është që të nxisë integrimin social dhe ekonomik të të gjithë target grupeve rinore, duke zbatuar parimin e barazisë gjinore dhe diskriminimit, integrimin e grupeve të marginalizuara në fushën e artit dhe kulturës.

Me anë të procesverbalit më datë 14.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. G.G, përfaqësues AKR dhe znj. A.M, përfaqësuese e organizatës Qendrës “M.S”, diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “we are all made of stars – formimi artistik dhe performancë në skenë për talentet e reja të Shqipërisë”, nga vlera fillestare e propozuar 2,805,050 lekë do reduktohet në vlerën 2,673,650 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.305, datë 03.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Qendra “M.S”, me objekt: “we are all made of stars – formimi artistik dhe performancë në skenë për talentet e reja të Shqipërisë.”, me vlerë financimi nga AKR 2,673,650 lekë, me afat 6 mujor .

Me Urdhrin nr.52 datë 10.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.75, datë 11.11.2021, në vlerën 1,336,825 lekë.

Përfituesi ka dorëzuar pranë AKR-së raportin fillestar financiar dhe përshkruar me datë 17.02.2022 në përputhje me nenin 7 të kontratës. AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar (pa datë) dhe më 30.03.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkruar në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.25 datë 01.04.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.22, datë 06.04.2022, në vlerën 1,069,460 lekë.

Organizata Qendra “M.S”, ka dorëzuar Raportin Final më datë 07.06.2022 dhe janë përfunduar relacionet përfundimtare.

Qendra “E.R”

Qendra “E.R” ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Rini- Art- Aktivizëm- 3.”

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në ri-vitalizimin e jetës social-kulturore të të rinjve në Bashkitë Fier, Patos dhe Roskovec dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në komunitet.

Është lidhur kontrata me nr.309, datë 04.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Qendra “E.R”, me objekt: “Rini- Art- Aktivizëm- 3” me vlerë financimi nga AKR 998,700 lekë, me afat 10 mujor . Me Urdhrin nr.67 datë 06.12.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.91, datë 10.12.2021, në vlerën 499,350 lekë. Qendra “E.R” ka dorëzuar shkresën më datë 14.06.2022, protokolluar pranë AKR me nr.186 prot. datë 20.06.2022 me lëndë Kërkesë për shtyrje e Festivalit “Rini – Art – Aktivizim 3”. Ku deklaroi se kërkohet shtyrje afati deri në datë 26.10.2022, për arsyet se një pjesë e të rinjve që ndjekin kurset e kanë të pamundur të frekuentojnë këtë periudhë sepse janë maturantë, një pjesë do të largohen për pushime veriore ose punë sezonale, data më e afërt në të cilën teatri Bylis është i disponueshëm për të realizuar festivalin final është data 26.10.2022.

AKR me anë të shkresës nr.188 prot. datë 21.06.2022 me lëndë kthim përgjigje për shtyrjen e afatit të projektit “Rini-Art-Aktivizim 3”, ka miratuar kërkesën për shtyrje të afatit të përfundimit të projektit deri më datë 26.10.2022.

Përfituesi ka dorëzuar pranë AKR-së raportin fillestar financiar dhe përshkruar me datë 15.06.2022 në përputhje me nenin 7 të kontratës. Me datë 04.07.2022, AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar dhe më 04.07.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkruar në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit. Me Urdhrin nr.46 datë 16.08.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.65, datë 06.09.2022, në vlerën 399,480 lekë. Qendra “E.R” është në përfundim të projektit dhe ka dorëzuar Raportin Final më datë 07.06.2022 dhe janë përfunduar relacionet përfundimtare.

. Grupi i auditimit konstatoi se:

- Dokumentacioni i dosjes së aplikimit është i fotokopjuar;
- Pagesa e kështit të parë është kryer 36 ditë kalendarike pas firmosjes së kontratës dhe pagesa e kështit të dytë është kryer 64 ditë pas miratimit të raportit fillestar. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 5 të Kontratës, ku citohet... “Kësti i parë duhet të shlyhet 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të Kontratës. Kësti i dytë duhet të shlyhet 15 ditë kalendarike pas miratimit të raportit fillestar.”

Sa më sipër, AKR nuk ka respektuar afatet e vendosura në kontratë për disbursimin e kështit të parë dhe të dytë, veprim ky në kundërshtim me nenin 5 të kontratës.

Fondacioni “Q.E”

Fondacioni Q.E ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Fuqizimi i të rinjve pas pandemisë: sfidat dhe mundësitë”.

Qëllimi i projektit është rritja e kapaciteteve të të rinjve për t’u përballur me dinamikën e tregut të punës post katastrofave natyrore Covid-19.

Me anë të procesverbalit më datë 13.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. G.G, përfaqësues AKR dhe znj. I.Xh, përfaqësuese e organizatës Fondacioni Q.E, diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Fuqizimi i të rinjve pas pandemisë: sfidat dhe mundësitë”, nga vlera fillestare e propozuar 2,985,000 lekë do reduktohet në vlerën 2,300,000 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.311, datë 05.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Fondacioni Q.E, me objekt: “Fuqizimi i të rinjve pas pandemisë: sfidat dhe mundësitë”, me vlerë financimi nga AKR 2,300,000 lekë, me afat 12 mujor .

Me Urdhrin nr.66 datë 06.12.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.90, datë 10.12.2021, në vlerën 1,150,000 lekë.

Përfituesi ka dorëzuar pranë AKR-së raportin fillestar financiar dhe përshkruar me datë 15.06.2022 në përputhje me nenin 7 të kontratës. Me datë 22.06.2022, AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar dhe më 27.06.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkruar në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.43 datë 01.08.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.60, datë 09.08.2022, në vlerën 920,000 lekë.

AKR është në pritje të raporteve përfundimtare nga ana e përfituesit, që më pas te vijoj me disbursimin e kështit të tretë.

Grupi i auditimit konstatoi se:

- Pagesa e kështit të parë është kryer 30 ditë kalendarike pas firmosjes së kontratës dhe pagesa e kështit të dytë është kryer 40 ditë pas miratimit të raportit fillestar. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 5 të Kontratës, ku citohet: “Kësti i parë duhet të shlyhet 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të Kontratës. Kësti i dytë duhet të shlyhet 15 ditë kalendarike pas miratimit të raportit fillestar.”

Sa më sipër, AKR nuk ka respektuar afatet e vendosura në kontratë për disbursimin e kështit të parë dhe të dytë, veprim ky në kundërshtim me nenin 5 të kontratës.

Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SV)

Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SV) ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Nga Fjala tek Veprimi- Aktivizim për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë”.

Qëllimi i projektit është që të fuqizojë të rinjtë në Tiranë, Korçë dhe Shkodrës për të qenë aktiv në komunitetin e tyre me fokus punën rinore përmes përdorimit të inovacionit dhe krijimtarisë për ndryshim shoqëror duke i përgatitur për të qenë të suksesshëm në sferën publike si edhe në tregun e punës përmes zhvillimit të aftësive dhe kompetencave bashkëkohore dhe me vlerë të shtuar në realitetin post-Covid19.

Me anë të procesverbalit me datë 26.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. I.L, përfaqësues të AKR-së dhe znj. BB, përfaqësuese e organizatës Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SV), diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Nga Fjala tek Veprimi- Aktivizim për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë”, nga vlera fillestare e propozuar 2,760,000 lekë do reduktohet në vlerën 2,516,00 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.307, datë 04.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim, me objekt: “Nga fjala tek veprimi – Aktivizim për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë”, me vlerë financimi nga AKR 2,516,000 lekë, me afat 7 mujor.

Me Urdhrin nr.50 datë 10.11.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.73, datë 18.11.2021, në vlerën 1,258,000 lekë. Përfituesi ka dorëzuar pranë AKR-së raportin fillestar financiar dhe përshkruar me datë 30.03.2022 në përputhje me nenin 7 të kontratës.

Me datë 22.04.2022, AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar dhe më 27.04.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkruar në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.30 datë 28.04.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.34, datë 24.05.2022, në vlerën 1,006,400 lekë.

Me shkresën me datë 27.05.2022, protokolluar në AKR me nr.170 prot. datë 30.05.2022 me lëndë “Kërkesë për shtyrje afati pa kosto të projektit deri më 30.06.2022”, Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SV) kërkon shtyrje afati deri më 30.06.2022 në mënyrë që të kenë hapësirë kohore për të bërë pagesat e mbetura dhe bërë raportimin përmbyllës. Dhe pse përfituesi i ka përfunduar të gjitha aktivitetet e parashikuara në kontratë, nuk ka mundur të bëjë të gjitha pagesat sipas buxhetit, pasi ka qenë në pritje të pagesën e kështit të dytë nga ana e AKR-së.

Me shkresën nr.171 prot., datë 31.05.2022 AKR ka miratuar kërkesën për shtyrje e projektit deri më 30.06.2022 duke sqaruar se vonesa e ardhur në kalimin e kështit të dytë është si pasojë e problematikave të krijuara nga kalimit i AKR -së në sistemin AFMIS.

Përfituesi ka dorëzuar pranë AKR-së raportin final financiar dhe përshkruar me datë 30.06.2022 në përputhje me nenin 7 të kontratës.

Me datë 06.09.2022 AKR-ja ka miratuar raportin përfundimtar të monitorimit financiar dhe më 12.09.2022 hartoi relacionin e raportit final përshkruar në lidhje me realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

Me Urdhrin nr.55 datë 23.09.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të tretë në masën prej 10% , likuiduar me urdhër shpenzimin nr.72, datë 23.09.2022, në vlerën 233,400 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se:

- dokumentacioni i mbajtur mbi monitorimin në terren për implementimin e projektit nuk është i plotë, pasi për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës në AKR.

- nga përfituesi është kërkuar shtyrje e afatit të kontratës, e cila është kërkuar disa ditë para mbarimit të afatit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me nenin 13 të kontratës ku citohet: “ Zgjatja në kohë e projektit ndodh pas një kërkesë nga Përfituesi, e dërguar të paktën 1(një) muaj përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga AKR.”

Organizata RD

Organizata RD ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Nga Vulnerabiliteti në Sipërmarrje”, projekti do të implementohet në Rajonin / Qarkun e Shkodrës, pra në Bashkitë e njësitë administrative të këtij qarku.

Qëllimi i projektit është i fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e profesional të të rinjve me ide inovative (pa të ardhura / me të ardhura të ulëta) dhe formimi i tyre në drejtim të sipërmarrjes inovative në mënyrë që të gjenerojë vetë të ardhura e të zhvillohen në nivel social – ekonomik. Në këtë mënyrë, përmes aftësisimit të të rinjve në sipërmarrje do të incentivohet punësimi dhe vetëpunësimi i tyre.

Me anë të procesverbalit me datë 12.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. I.L, përfaqësues të AKR-së dhe znj. XSh (Përfaqësuese me autorizim datë 14.10.2021 e drejtores ekzekutive znj. E.H), përfaqësuese e Organizatës “R.Zh” diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Nga vulnerabiliteti në sipërmarrje”, nga vlera fillestare e propozuar 2,995,000 lekë do reduktohet në vlerën 2,745,00 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.308, datë 04.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Shoqatës “R.Zh”, me objekt zbatimi i projektit: “Nga vulnerabiliteti në sipërmarrje”, me vlerë financimi nga AKR 2,745,000 lekë, me afat 6 mujor.

Me Urdhrin nr.63 datë 26.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.83, datë 06.12.2021, në vlerën 1,372,500 lekë.

Kësti i parë është paguar rreth 1 muaj pas nënshkrimit të kontratës dhe jo 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës, në kundërshtim në nenin 5 të kontratës Mënyra e financimit të projektit (tabela e pagesave), ku përcaktohen dhe afatet për pagesën.

Përfituesi ka dërguar pranë AKR-së raportin financiar dhe përshkruar me datë 30.04.2022, në përputhje me nenin 7 të Kontratës. Me datë 05.06.2022, AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar dhe më 10.06.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkruar në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.37 datë 20.06.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.42, datë 20.06.2022, në vlerën 1,098,000 lekë.

Shoqata RD ka dorëzuar shkresën më datë Prill 2022, protokolluar pranë AKR me nr.92 prot. datë 05.04.2022 me lëndë Kërkesë për shtyrje afati. Ku deklaroi se përfituesi ka hasur vështirësi në hedhjen e të dhënave të grumbulluara të projektit në një data bazë përmbledhëse dhe përpunimin e tyre, pasi kërkohet më shumë kohë në dispozicion nga burimet njerëzore të dedikuara. Gjithashtu për arsye të sistemit të fiskalizimit, kanë hasur vështirësi në marrjen e faturave fiskale nga palët e treta kërkohet shtyrje afati deri në datë 15.07.2022, qe të kenë mundësi të përmbyllin e raportojnë në kohë aktivitetet.

AKR me anë të shkresës nr.92/1 prot. datë 05.04.2022 me lëndë kthim përgjigje shkresës protokolluar me nr.92 datë 05.04.2022, ka miratuar kërkesën për shtyrje të afatit të përfundimit të projektit pa kosto deri më datë 15.07.2022.

Grupi i auditimit konstatoi se dokumentacioni i mbajtur mbi monitorimin në terren për implementimin e projektit nuk ishte i plotë, pasi për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës.

Për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës.

Shoqata e SH.U

Shoqata e SH.U ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Mundësitë profesionale dhe sipërmarrëse për të rinjtë”, projekti do të implementohet në Tiranë, Lezhë, Durrës, Kavajë, Elbasan.

Qëllimi i projektit është rritja e kapacitetit të të rinjve nëpërmjet formimit profesional formal dhe joformal. Përmes kurseve profesionale, këshillimit të karrierës, cikleve të trajnimit, procesit të thelluar të mentorimit synohet punësimi i të rinjve pjesëmarrës. Projekti po ashtu synon krijimin e një rrjeti biznesesh të cilat do të mundësojnë praktikat profesionale, punësim të të rinjve. Një përfaqësues nga bizneset do të trajnohet për tu bërë mentor i këtyre të rinjve në biznesin përkatës me qëllim vazhdimësinë e filozofisë që do të krijojë projekti për dhënien e mundësisë të punësimit dhe formimit profesional në vazhdimësi.

Në Vendimit nr.1141, datë 24.12.2020 *“Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”*, përcaktohen dokumentacioni i nevojshëm për kualifikimin e subjekteve konkurruese.

Vërtetim nga gjykata që përfaqësuesi ligjor i organizatës nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë mban datën 02.09.2021.

Mungon dokumentacioni që provon përvojën në zhvillimin e aktiviteteve rinore.

Me anë të procesverbalit me datë 12.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. I.L, përfaqësues të AKR-së dhe znj. A.K, përfaqësues i Organizatës “Shoqata e SH.U” diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Mundësitë profesionale dhe sipërmarrëse për të rinjtë”, nga vlera fillestare e propozuar 2,842,000 lekë do reduktohet në vlerën 2,642,00 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.306, datë 03.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Shoqata e SH.U, me objekt zbatimi i projektit: “Mundësitë profesionale dhe sipërmarrëse për të rinjtë”, me vlerë financimi nga AKR 2,642,000 lekë, me afat 12 mujor.

Me Urdhrin nr.54 datë 17.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.78, datë 18.11.2021, në vlerën 1,321,000 lekë.

Përfituesi ka dërguar pranë AKR-së raportin financiar (pa datë) (në relacion financiar periudha është 12.10.2021 deri 11.10.2023) dhe përshkrues me datë 27.04.2022, në përputhje me nenit 7 të Kontratës. Me datë 06.06.2022, AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar dhe më 06.06.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkrues në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.38 datë 20.06.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimin nr.43, datë 20.06.2022, në vlerën 1,056,800 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se dokumentacioni i mbajtur mbi monitorimin në terren për implementimin e projektit nuk ishte i plotë, pasi për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës.

F.SH

F.SH ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Rinia e së ardhmes, mes jetës universitare, sportit dhe vullnetarizmit”, projekti do të implementohet në Rajonin Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodrës, Korçë dhe Rubik, Mirditë.

Qëllimi i projektit është përfshirja dhe integrimi social dhe orientimi drejt së ardhmes i rinisë studentore shqiptare duke i angazhuar ata në veprimtari me vlerë, në inisiativa dhe aktivitete rekreative të shëndetshme dhe edukative, të cilat do të mbulojnë kohën e tyre të lirë duke stimuluar sjelljen e mirë dhe praktikimin e një stili jetese me vlera dhe të shëndetshëm.

Me anë të procesverbalit me datë 15.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. B.D, përfaqësues të AKR-së dhe z. B.V, përfaqësues i Organizatës F.SH diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Rinia e së

ardhmes, mes jetës universitare, sportit dhe vullnetarizmit”, nga vlera fillestare e propozuar 3,000,000 lekë do reduktohet në vlerën 2,600,00 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.315, datë 09.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe F.U, me objekt zbatimin e projektit: “Rinia e së ardhmes, mes jetës universitare, sportit dhe vullnetarizmit”, me vlerë financimi nga AKR 2,600,000 lekë, me afat 6 mujor.

Me Urdhrin nr.65 datë 26.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.85, datë 06.12.2021, në vlerën 1,300,000 lekë.

Kësti i parë është paguar 27 ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe jo 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës, në kundërshtim në nenin 5 të kontratës Mënyra e financimit të projektit (tabela e pagesave), ku përcaktohen dhe afatet për pagesën.

Përfituesi ka dërguar pranë AKR-së raportin financiar dhe përshkrues për periudhën 9 nëntor 2021- 11 shkurt 2022 (pa datë), në përputhje me nenin 7 të Kontratës. Me datë 30.03.2022, AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar dhe më 31.03.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkrues në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.24 datë 01.04.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.23, datë 06.04.2022, në vlerën 1,040,000 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se dokumentacioni i mbajtur mbi monitorimin në terren për implementimin e projektit nuk ishte i plotë, pasi për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës.

Observacion i subjektit mbi Projektraportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 20.12.2022 me nr.475/1. prot.

Pretendimi i Subjektit: Organizata “F.SH “ka dorëzuar Raportet Finale, të cilat janë shqyrtuar nga AKR dhe bazuar në raportin e monitorimit financiar dhe relacionin përfundimtar është disbursuar kësti kontraktual më Urdhër nr.67, datë 17.11.2022.

Observacioni meret në konsideratë.

“L”

Organizata “L” ka aplikuar për thirrjen për projektin me titull: “Re-Debate Kampionati Kombëtar i Debatit”, me kohëzgjatje 11 muaj.

Qëllimi i projektit është organizimi i një programi të mirëfilltë debatesh dhe një procesi të zhvillimit të mendimit kritik për nxënësit e shkollave të mesme në nivel kombëtar.

Është lidhur kontrata me nr.300, datë 02.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Shoqatës “L”, me objekt: “Re-Debate Kampionati Kombëtar i Debatit”, me vlerë financimi nga AKR 2,600,000 lekë, me afat 11 mujor.

Nga AKR është hartuar raporti fillestar në datën 22.06.2022

Me Urdhrin nr.55 datë 17.04.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.77, datë 18.11.2021, në vlerën 1,300,000 lekë. Përfituesi ka dorëzuar pranë AKR-së raportin fillestar financiar dhe përshkrues në përputhje me nenin 7 të kontratës.

Me datë 22.06.2022(në raportin lidhur urdhër shpenzimit është data 12.06.2022), AKR-ja hartuar raportin të monitorimit financiar dhe më 22.06.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkrues në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.39 datë 24.06.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.48, datë 24.06.2022, në vlerën 1,040,000 lekë.

Me datë 12.09.2022 AKR-ja ka miratuar raportin përfundimtar të monitorimit financiar .

Me Urdhrin nr.54 datë 23.09.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të tretë në masën prej 10% , likuiduar me urdhër shpenzimit nr.71, datë 23.09.2022, në vlerën 260,000 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se:

- dokumentacioni i mbajtur mbi monitorimin në terren për implementimin e projektit nuk është i plotë, pasi për monitorimet e kryera nuk kishte procesverbale të mbajtura nga personat përgjegjës në AKR.

Shoqata TV

Shoqata TV ka aplikuar për thirrjen e parë për projektin me titull: “Ringjallja e zanateve tradicionale përmes brezit të ri.”

Qëllimi i projektit është nxitja e punësimit të rinjve përmes sipërmarrjes artizanale dhe tradicionale.

Me anë të procesverbalit më datë 13.10.2021 mbajtur midis znj. J.Sh., znj. B.S përfaqësues AKR dhe z. A.Ç, përfaqësues i organizatës Qendrës “TV”, diskutuan për rishikimin e zërave të buxhetit, ku palët ranë dakord që shuma përfundimtare e financimit të projektit “Ringjallja e zanateve tradicionale përmes brezit të ri”, nga vlera fillestare e propozuar 2,812,000 lekë do reduktohet në vlerën 2,497,000 lekë.

Është lidhur kontrata me nr.321, datë 15.11.2021, midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Shoqata TV me objekt: “Ringjallja e zanateve tradicionale përmes brezit të ri”, me vlerë financimi nga AKR 2,497,000 lekë, me afat 10 mujor .

Me Urdhrin nr.64 datë 26.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të parë në masën 50%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.84, datë 14.12.2021, në vlerën 1,248,500 lekë.

Përfituesi ka dorëzuar pranë AKR-së raportin fillestar financiar dhe përshkruar me datë 29.04.2022 në përputhje me nenin 7 të kontratës.

Me datë 02.06.2022, AKR-ja ka miratuar raportin fillestar të monitorimit financiar dhe më 13.06.2022 hartoi relacionin e raportit fillestar përshkruar në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit.

Me Urdhrin nr.44 datë 01.08.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AKR-së urdhëroi realizimin e disbursimit të kështit të dytë në masën 40%, likuiduar me urdhër shpenzimit nr.59, datë 09.08.2022, në vlerën 998,800 lekë.

Shoqata TV është në përfundim të projektit dhe së shpejti pritet të dorëzohet dosja me raportet përfundimtare.

Grupi i auditimit konstatoi se:

- Paguesa e kështit të parë është kryer 29 ditë kalendrike pas firmosjes së kontratës dhe pagesa e kështit të dytë është kryer 68 ditë pas miratimit të raportit fillestar. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 5 të Kontratës, ku citohet...“Kësti i parë duhet të shlyhet 15 ditë kalendrike pas nënshkrimit të Kontratës. Kësti i dytë duhet të shlyhet 15 ditë kalendrike pas miratimit të raportit fillestar.”

Sa më sipër, AKR nuk ka respektuar afatet e vendosura në kontratë për disbursimin e kështit të parë dhe të dytë, veprim ky në kundërshtim me nenin 5 të kontratës.

Titulli i gjetjes	<i>Mbi projektet për organizatat</i>
Situata:	Agjencia Kombëtare e Rinisë ka mbështetur realizimin e 12 projekteve për organizatat. Nga auditimi mbi projektet për organizatat u konstatuan problematikat si më poshtë vijon: - Në dosjen e organizatës Qendra “E.R” konstatohet se dokumentacioni i dosjes së aplikimit është i fotokopjuar, si dhe AKR nuk ka respektuar afatet e vendosura në kontratë për disbursimin e kështit të parë dhe të dytë; -Për organizatën Fondacioni “Q.E”, AKR nuk ka respektuar afatet e vendosura në

	<p>kontratë për disbursimin e kështit të parë dhe të dytë;</p> <p>-Për organizatën Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SV), nga përfituesi është kërkuar shtyrje e afatit të kontratës, e cila është kërkuar disa ditë para mbarimit të afatit të kontratës;</p> <p>- Për organizatën F.SH konstatohet se mungojnë raportet përfundimtare;</p> <p>- Për organizatën Shoqata TVAKR nuk ka respektuar afatet e vendosura në kontratë për disbursimin e kështit të parë dhe të dytë.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 5, nenin 7, dhe nenin 13 të Kontratës e lidhur ndërmjet AKR-së dhe organizatave.</p>
Kriteri:	<i>Ligji nr. 75, Datë 04.11.2019 “Për Rininë”;</i> <i>VKM nr.681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos pagesa në kohë e kësteve për organizatat
Shkaku:	Mos respektimi i termave të kontratës
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Nga ana e strukturës përgjegjëse në AKR, në vijimësi të merren masa për respektimin e afateve të pagesave të kësteve dhe të shtyrjes të afatit të përfundimit të projektit sipas kontratës e lidhur midis AKR-së dhe organizatave.

-Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e projekteve që janë në proces nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe ato që kanë përfunduar nuk janë të numëruara dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

*Nga auditimi u konstatua se për të gjitha procedurat e projekteve për Rininë **nuk** ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta, e cila ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve.*

U konstatua se edhe ato subjekte që i janë nënshtruar monitorimit, në fakt nuk janë dokumentuar me shkresa zyrtare por sipas institucionit vetëm nëpërmjet emailleve gjë e cila është e pamjaftueshme për të parë performancën e subjekteve përfituese .

Monitorimi i projekteve duhet parë si një funksion thelbësor i aktivitetit të AKR-së, për të cilin duhet të ngrihen dhe funksionojnë struktura të plota dhe aktive, të afta të mbulojnë me monitorim një pjesë përfaqësuese të projekteve në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme mbi përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Titulli i gjetjes	<i>Mbi numerizimin dhe inventarizimin e dosjeve</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e projekteve që janë në proces nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit, si dhe ato që kanë përfunduar nuk janë të numëruara dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit sipas rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.
Kriteri:	-Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”
Ndikimi/Efekti:	-Evidencimin, sistemimi dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.
Shkaku:	Mos numerizimi, inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të projekteve dhe dosjeve të personelit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Titulli i gjetjes	<i>Mbi monitorimin e projekteve për Rininë</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua se për të gjitha procedurat e projekteve për Rininë nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta, e cila ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve. U konstatua se edhe ato subjekte që i janë nënshtruar monitorimit, në fakt nuk janë dokumentuar me shkresa zyrtare por sipas institucionit vetëm nëpërmjet emaileve gjë e cila është e pamjaftueshme për të parë performancën e subjekteve përfituese . Monitorimi i projekteve duhet parë si një funksion thelbësor i aktivitetit të AKR-së, për të cilin duhet të ngrihen dhe funksionojnë struktura të plota dhe aktive, të afta të mbulojnë me monitorim një pjesë përfaqësuese të projekteve në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme mbi përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.
Kriteri:	Ligji nr. 75, Datë 04.11.2019 “Për Rininë” VKM nr.681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”,
Ndikimi/Efekti:	1- Mos dokumentimi i monitorimit i projekteve 2-Mungesa e një analize të hollësishme mbi ecurinë e projekteve
Shkaku:	Mos hartimi i një plani periodik me objektiva të qarta mbi monitorimin e projekteve. Mos dokumentimi i monitorimit të projekteve.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga ana e strukturës përgjegjëse për monitorim, në AKR, të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik, të kujdesshëm dhe përfaqësues, dhe me objektiva të qarta për projektet në fushën e Rinisë, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet dhe ekonomicitet.

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk janë ndërmarrë hapa për zhvillimin e kompetencave të rëndësishme për hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit mbi situatën e të rinjve; zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore; nuk janë monitoruar standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë, të parashikuara në Ligjin nr.75/2019 “Për Rininë” neni 5.

Gjithashtu nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nuk janë hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikat, për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, nuk ka hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikat, për marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës; sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit, në zbatimin të VKM-së nr. 524, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët” pikat 3 dhe 4.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të merren masa të menjëhershme lidhur me hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit të situatës së rinjve, monitorimi i politikave dhe veprimtarive rinore, monitorimi i standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore, duke dhënë në këtë mënyrë një vlerësim aktual mbi situatën reale të rinjve në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë dhe në Vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e projekteve që janë në proces nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit, si dhe ato që kanë përfunduar nuk janë të numëruara dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidentimin, sistemin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për të gjitha procedurat e projekteve për Rininë nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta, e cila ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve.

U konstatua se edhe ato subjekte që i janë nënshtruar monitorimit, në fakt nuk janë dokumentuar me shkresa zyrtare por sipas institucionit vetëm nëpërmjet e-maileve gjë e cila është e pamjaftueshme për të parë performancën e subjekteve përfituese .

Monitorimi i projekteve duhet parë si një funksion thelbësor i aktivitetit të AKR-së, për të cilin duhet të ngrihen dhe funksionojnë struktura të plota dhe aktive, të afta të mbulojnë me monitorim një pjesë përfaqësuese të projekteve në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme mbi përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e strukturës përgjegjëse për monitorim, në AKR, të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik, dhe përfaqësues, dhe me objektiva të qarta për projektet në fushën e Rinisë, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me eficientë dhe efektivitet.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Rinisë ka mbështetur realizimin e 12 projekteve për organizatat, për të cilat u konstatuan disa problematika si: në tre organizata, nuk janë respektuar afatet të vendosura në kontratë për disbursimin e kësteve, në një organizatë konstatohet se dokumentacioni i dosjes së aplikimit është i fotokopjuar, në një organizatë konstatohet se nga përfituesi është kërkuar shtyrje e afatit të kontratës, e cila është kërkuar disa ditë para mbarimit të afatit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me nenin 13 të kontratës ku përcaktohet se zgjatja në kohë e projektit ndodh pas një kërkesë nga Përfituesi, e dërguar të paktën 1(një) muaj përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga AKR; në një organizatë konstatohet se mungojnë raportet përfundimtare. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 5, nenin 7, dhe nenin 13 të Kontratës e lidhur ndërmjet AKR-së dhe organizatave.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e strukturës përgjegjëse në AKR, në vijimësi të merren masa për respektimin e afateve të pagesave të kësteve dhe të shtyrjes të afatit të përfundimit të projektit sipas kontratës së lidhur midis AKR-së dhe organizatave.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se:

5.1. AKR-ja nuk ka përgatitur dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, formatet e raporteve të PBA-së, si dhe nuk ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 1.5 dhe paragrafi 2.5 pika 1/a, paragrafi 2.5 pika 5.

5.2. Për periudhën objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12-mujore të buxhetit. AKR-ja financohet nga buxheti i shtetit për programin Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit me financim të brendshëm konsistojnë në rakordimet që AKR-ja bën me Ministrinë e linjës për rininë për arritjen e objektivave për të cilat alokohen këto fonde. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12-mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr.9, date 20.3.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore” dhe të Udhëzimit nr.22 dt.17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të AKR-së të marrë masa për krijimin Ekipit të Menaxhimit të Programit, hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm së bashku me formatet e raporteve të PBA-së, çdo vit, me qëllim për të mundësuar një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Rekomandimi: AKR-ja të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit për çdo katër mujor, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimit sa më efektiv të fondeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse, duke ju referuar VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit, janë konstatuar mangësitë si më poshtë: Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit; dosjet e personelit shoqërohen nga fleta e inventarit; kontrata individuale e punës; vlerësimi periodik i performancës; dokumentacion të panoterizuar; librezat e punës e paplotësuar me datën e fillimit të punës; lista e notave; Dëshmi penaliteti., veprime në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKR-ja nuk ka lidhur një Kontratë Individuale të Punës me secilin nga punonjësit e institucionit, si dhe nuk ka një kontratë tip, ku të përcaktohen të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës si: identitetin e palëve; vendin e punës; c. përshkrimin e përgjithshëm të punës; datën e fillimit të punës; kohëzgjatjen kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; kohën normale javore të punës; kontrata e punës duhet të përmbajë dhe kontratën kolektive.

Ky veprim është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11 pika 1 dhe neni 21 pika 3.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që të hartojë një format tip që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës dhe të lidhë Kontrata Individuale të Punës me secilin nga punonjësit e institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e Brendshme e institucionit është miratuar me Urdhër të Ministrit të MASR nr. 103, datë 06.03.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Kombëtar për Rininë”. Me VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, është krijuar institucioni i AKR-së, të cilës i ka kaluar numri i punonjësve, buxheti i planifikuar dhe të gjitha asetet e Shërbimit Kombëtar për Rininë. Dhe pse kanë ndodhur këto ndryshime, AKR vazhdon të funksionojë sipas kësaj rregullore, e cila nuk është përditësuar me bazën ligjore në fuqi. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 681, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” pika 5 dhe 6.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët të marrin masa për përditësimin e rregullores sipas ndryshimeve të ndodhura në organikën dhe strukturën e AKR-së.

Brenda 6 muajve

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga 4 projektet e fituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, 3 prej tyre në përfundim të afatit të kontratave nuk e kanë filluar ende implementimin e projekteve në kundërshtim me kontratat e lidhura. Përkatësisht 1-Bashkia Tiranë me projektin: “Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për të Rinjtë, Petrelë” ka lidhur kontratën nr.363, datë 23.11.2021, me vlerë financimi nga AKR 3,186,489 lekë, me afat 12 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 2,867,840 lekë sipas kontratës. 2-Bashkia Elbasan me projektin “Talent St-Art-Up Elbasan 2”, ka lidhur kontratën me nr.5374, datë 03.11.2021, vlerë financimi nga AKR 5,503,842 lekë, me afat 10 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 4,953,485 lekë sipas kontratës.

3-Bashkia Lezhë me projektin “Rikonstruksioni i Qendrës Rinore Lezhë” ka lidhur kontratën me nr. 19199, datë 05.11.2021 vlerë financimi nga AKR 8,541,077,6 lekë, me afat 12 mujor.

Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 7,686,970 lekë sipas kontratës. Në këto kushte vlera e financuar nga AKR prej 15,508,295 lekë nuk është përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet, pasi konstatuam se projektet ende nuk kishin nisur fazën e implementimit në kundërshtim me kontratën.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga MSHRF dhe AKR të merren masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos fillimin e implementimit të projekteve të bashkive, referuar kontratave së lidhur midis AKR-së dhe Bashkive Tiranë, Elbasan, Lezhë duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 15,508,295 lekë.

Menjëherë

V. ANEKSE

Anekset japin informacion mbi:

Aneksi 1. “Sqarim rreth llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga KLSH”;

Aneksi 2. “Qasja dhe metodologjia e auditimit”;

Aneksi 3. “Analiza e risqeve”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSI I - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Llojet e opinionëve të aplikuara nga KLSH.

A. Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

1. **Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë)** jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;

(b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;

(c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe

(d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Opinionit me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

B. **Audituesi e modifikon opinionin**, duke shprehur:

1. **Opinionit i kualifikuar.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose

2. audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

2. **Opinionit negativ (kundërshtues).**

Opinionit negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinionit qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

3. **Refuzim i opinionit.**

Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI II

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Gjatë procesit të planifikimit, janë mbledhur informacion për subjektin në mënyrë që të vlerësohet risku dhe të përcaktohen nivelet e materialitetit për hartimin e procedurave të auditimit. Evidencat e mbledhura më pas janë vlerësuar si një bazë për formimin e përfundimeve dhe për qëllime raportimi. Materialiteti është i rëndësishëm për këtë vlerësim.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe kryqëzimin e tyre me të dhënat e gjeneruara nga databaza e sistemit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, si edhe rakordimi në situacionet e Thesarit.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Konkretisht, mbi të dhënat e disponuara aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm; dhe

- teste të detajeve

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;

- Pësha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, cilësia ose efektiviteti i sistemeve të kontrollit mund të përcaktohet në bazë të nivelit 0,7- 2% të materialitetit nëse auditimi jep siguri të arsyeshme (për shembull, bazuar mbi teste të mjaftueshme kontrolli dhe/ose teste thelbësore):

- kur një dobësi e sistemit nuk sjell gabime material, në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si “efektiv”;

- kur gabimet/parregullsitë, të cilat nuk janë parandaluar, zbuluar dhe korrigjuare tejkalojnë pragun e materialitetit prej 2%.; në këto raste, sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si “pjesërisht efektiv” ose “jo efektiv”.

Përzgjedhjen e urdhër pagesave është bërë duke parë brenda kontekstit të natyrës specifike të shpenzimeve, të cilat mbartin risk, duke marrë në konsideratë dhe faktorët si:

- vlerat e pagesës

- ngjarje apo transaksione të rëndësishme si kontrata të rëndësishme prokurimi, kontrata për investime afatgjatë, të cilat mund të jenë shkas për ndonjë risk më të lartë.

- afati kohor që nga data urdhër pagesës me datën e faturës së lëshuar për kryerjen e shërbimit, për të analizuar arsyen e këtyre vonesave në ekzekutim, duke kaluar afatin 30 ditore të parashikuar në legjislacion.

- ekzekutimi i pagesave ne lidhje me vendimet e formës së prerë dhe kthimin e tij në titull ekzekutiv, duke marrë parasysh afatin e zgjatjes së pagesës nga vendimi deri në ekzekutimin e pagesës nga institucioni.

ANEKSI III:

ANALIZA E RISQEVE:

1.Risku i brendshëm (i trashëgueshëm) IR për MSHRF dhe AKR:

Risku i brendshëm i shmangies nga përputhshmëria, ose gabimi, është analizuar nga grupi i auditimit duke përdorur gjykimin në vlerësimin e një sërë faktorësh, (në referencë të kreut 4.2 të MAP të KLSH, fq. 33- 35), që përfshijnë:

Shkallëzimi IR:

Risku i ulët: ngjyrë jeshile, deri në 0,5

Risku i moderuar: ngjyrë verdhë, 0.6 deri në 0,9

Risku i larte: ngjyrë kuqe, 1

- kompleksitetin e strukturave menaxhuese: verdhe, vlerësuar **0,6**
- kompleksitetin e kuadrit normues dhe ligjor: jeshile, vlerësuar **0.4**
- hyrjen në zbatim të dispozitave të reja ligjore ose ndryshimet në rregullat ekzistuese: verdhë, vlerësuar **0,7**
- shërbime dhe programe të realizuara nga palë të treta: jeshile deri tek e verdhë në pak raste, vlerësuar **0,8**
- pagesa dhe fatura të kryera mbi baza pretendimesh ose deklarimesh: (nuk janë vërtetuar raste të tilla nga testimi), jeshile, vlerësuar **0,3**
- numrin dhe shumë llojshmërinë e përfituesve: verdhë, vlerësuar **0,8** meqenëse nomenklatura e çështjeve që trajtohen dhe operatorëve që operojnë është shumë e shtrirë dhe mund të kërcënohet nga risqet e keqmenaxhimit material.

Mesatarja për 6 zërat e listuar më sipër: $3,6/6 = 0,6$ d.m.th ngjyrës te verdhë, risk i mesëm.

2. Risku i kontrollit (CR) për institucionin e MSHRF -së dhe AKR-së:

Risku i kontrollit është risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigjohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Kur audituesi parashikon të mbështetet në vlerësimin e riskut të kontrollit për të zvogëluar shkallën e përdorimit të procedurave thelbësore (substantive) sa i takon përputhshmërisë, ai kryen gjithashtu vlerësime paraprake të riskut të kontrollit dhe planifikon e kryen teste të kontrollit, në mënyrë që të mbështesë këtë vlerësim. (Shiko fq. 34 të manualit)

Statusi i kontrollit te brendshëm	Risku i kontrollit	Përshkrimi	Risku i kontrollit për MSHRF -në dhe AKR-në
Shumë i mirë	I ulët Deri në 0.15	kontrollat kanë funksionuar vazhdimisht në mënyrë efektive, gjatë gjithë periudhës në shqyrtim.	
I mirë	I ulët 0.15 - 0.25	janë vërejtur mangësi në efektivitetin dhe vazhdimësinë e kontrollit, por sistemi në tërësi nuk konsiderohet “jo i besueshëm”.	I mesëm (vlerësuar 0.21)

dobët	I lartë 0.26 - 1.0	kontrollat janë të pabesueshme, p.sh. kontrollat nuk kanë funksionuar sipas pritshmërive dhe/ose në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës nën shqyrtim, dhe/ose nuk është i mundur testimi i tyre.	
-------	-------------------------------------	--	--

3. Risku i moszbulimit (DR) për institucionin e MSHRF -së dhe AKR-së:

Risku i moszbulimit është risku që grupi i auditimit të mos zbulojë gabime materiale të cilat kanë ndodhur dhe nuk janë parandaluar ose zbuluar dhe korrigjuar në kohë nga sistemi i kontrollit të brendshëm.

“Kontrolli i Lartë i Shtetit kërkon një nivel sigurie 95% nga testet e kryera, që mund të vijnë nga kontrollat ose tërësisht nga procedurat thelbësore, në varësi të vlerësimit të audituesit sa i takon riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit” (faqe 35). Për institucionin e KLSH risku i auditimit është pranuar 5 %. Pra **AR= 5%**.

Risku i auditimit AR:

$$AR = IR \times CR \times DR$$

$$5\% = 0.63 \times 0.23 \times DR$$

$$0.05 = 0.63 \times 0.23 \times DR$$

$$DR = 0.05 / 0.126 = 0.39 < 5\%$$

PERZGJEDHJA E KAMPIONIT TË AUDITIMIT:

Tre mënyrat e përzgjedhjes së kampioneve: Statistikore dhe Jostatistikore:

- Përzgjedhja e 100% të artikujve,
- Përzgjedhja e artikujve të veçantë;
- Testimi i kampionëve